



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional në:
“Kujdes Social dhe Shëndetësor”
Kolegji Universitar “Qiriazi”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Entela Haloci

Prof. Asoc. Enkeleint Mechili

Qershor/ 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Programi i studimit me karakter profesional në “Kujdes Social dhe Shëndetësor”**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Qiriazi”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Rekreacionit Sportiv
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimi me karakter profesional në: “Kujdes Social dhe Shëndetësor”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhëri MAS Nr. 408, datë 14-07-2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Program profesional 2-vjeçar
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike (4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	11 PAE dhe 4 PAK
18	Numri i studentëve:	21 (8 vit i parë 2022 -2023 (13 vit i dytë 2023-2024)
evi19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar “Qiriazi” (KUQ) është një Institucion jo publik i Arsimit të Lartë i krijuar me Vendimin e Ministrisë së Arsimit që prej vitit 2006 i liçensuar me VKM Nr. 274, datë 10.05.2006. Universiteti është i akredituar më herët me VBA Nr. 52, datë 09.09.2022. KUQ bazon veprimtarinë e vet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015. KUQ ka në përbërjen e vet katër (4) Njësi Kryesore, tetë (8) Njësi Bazë si dhe dy (2) Qendra Kërkimore. KUQ ofron 17 programe studimi, përkatësisht: 5 diploma profesionale, 5 programe studimi të ciklit të parë “Bachelor”; 6 programe studimi të ciklit të dytë, 3 “Master profesional”, 3 “Master i shkencave” dhe 1 program të integruara të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave. Njësitë Kryesore të Kolegjit Universitar “Qirjazi” janë:

1. Fakulteti i Drejtësisë;
2. Fakulteti i Ekonomisë
3. Fakulteti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit;
4. Kolegji Profesional i Lartë;

Fakulteti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit ku ofrohet dhe programi i studimit me karakter profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”, ka në përbërjen e vet:

- Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporte;
- Departamenti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Rekreacionit Sportiv;
- Qendra Kërkimore –Shkencore;

Departamenti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Rekreacionit Sportiv ofron 2 programe studimi të cilat janë Bsc në ‘Edukim Fizik dhe Sporte, si dhe programin DP “Kujdes Social dhe Shëndetësor”. Departamenti funksionon si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore, për programet respektive të studimit që ofron. Programi i studimit me karakter profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor” ofrohet që prej vitit 2022 bazuar në Urdhërin e MAS Nr. 408, datë 14-07-2022. Programi ka në total 21 studentë (8+13). Ky është akreditimi i parë i këtij programi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit me karakter profesional 2-vjeçar “Kujdes Social dhe Shëndetësor” që ofrohet nga Departamenti i **Edukimit, Shkencave Sociale dhe Rekreacionit Sportiv** të Fakultetit të Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit, në Kolegjin Universitar, Qiriazit, shqyrtoi me kujdes, dokumentacionin e ofruar nga institucioni, dhe në bazë të tyre bëri ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga AU, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Në kuadër të procesit të jashtëm të vlerësimit është përgatitur agjenda nga ASCAL dhe u planifikua vizita në datat 28-29 Shkurt. Për arsye madhore, vizita u anulua në ato data dhe u zhvillua më 1 Mars, 2024. Dy ekspertët e përzgjedhur shoqëroheshin nga një specialist i ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm kishte në përbërje **Prof. Asoc. Entela Haloci** dhe **Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli**. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Anilda Beqiraj.

Bazuar në agjendën e përgatitur nga ASCAL u zhvilluan takimet me Drejtuesin e Njesisë Bazë (Drejtuesi i Njesisë Kryesore për arsye familjare nuk ishte prezent në takim siç u informuam nga Institucioni), grupin e vlerësimit të brendshëm, anëtarë të stafit akademik dhe studentët. Paralelisht, u zhvilluan dhe takime me përfaqësues të Zyrës së Marrdhënieve me Jashtë e Pranimeve dhe e Këshillimit për Karrierë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivit, përfaqësues të Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave, dhe përfaqësues të Qendrës Kërkimore-Shkencore. Paralelisht, u zhvilluan vizita në ambientet e Fakultetit. Gjatë vizitës në Institucion u panë klasa, laboratorë të ndryshëm si dhe biblioteka. Kohëzgjatja e takimeve ishte ajo e parashikuara.

Me përfundimin e takimeve, GVJ takoi Drejtuesin e Departamentit ndërsa eksperti i ASCAL informoi koordinatoren Institucional mbi disa dokumenta shtesë. Në përfundim të vizitave, ekspertët në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, takimeve të zhvilluara si dhe vizitës në ambientet e Institucionit hartuan Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

Më datë 31/05/2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 76/11 Prot. datë 31/05/2024, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Kolegji ktheu përgjigje përmes AMS, më datë 06/06/2024, me shkresë zyrtare Nr. 87/Prot., datë 05/06/2024. Komente nuk ka, Drafti kalon në Raport përfundimtar.

Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në “Kujdes Social dhe Shëndetësor”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programet e studimit që ofrohen nga Kolegji Universitar “Qiriazi” (KUQ) nuk bien ndesh me interesat kombëtare. KUQ vepron në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore. KUQ, në të gjithë veprimtarinë e tij, ka për qëllim: 1) të përgatisë specialistë të lartë me dije të nivelit bashkëkohor në programet e studimit të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin; 2) të kryejë studime e kërkime shkencore në fushat dhe sektorët që mbulon, në bashkëpunim me institucione homologe e sipërmarrje private; 3) të hyjë në marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë, brenda e jashtë vendit, me synim edhe bashkë-realizimin e programeve të studimit dhe lëshimin e diplomave të përbashketa apo/dhe të dyfishta. Traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, janë baza e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të ndërthurura me standardet dhe arritjet më të mira nderkombëtare në përgjithësi dhe ato evropiane në veçanti.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i KUQ.</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit “Kujdes Social dhe Shëndetësor” është i hartuar dhe ofrohet nga Fakulteti i Edukimit, Shkencat Sociale dhe Sportit dhe Departamenti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Rekreacionit Sportiv. Një nga objektivat kryesore të KUQ është të përgatisë specialistë të lartë me dije të nivelit bashkëkohor në programet e studimit të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. KUQ ka për mision: a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe të nxisë e të zhvillojë edukimin fizik dhe sportet; b) të formojë specialistë të lartë, profesionist, në përputhje me prioritetet e</p>

	<p>zhvillimit të institucionit dhe te vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend; c) të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimiti i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës; d) të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe sportiv në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare e) të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; f) të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor; g) të nxisë bashkëpunimin kombëtar, ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë. Ky program studimi ofrohet në përputhje me misionin, qëllimet dhe strategjinë e Institucionit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i KUQ; - Evidenca 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit; - Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit; - Evidenca 3.1 Rregullore e Programit të studimit.
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Strategjia e KUQ përcakton qartë rolin dhe misionin e duke përfshirë aty edhe shtyllat kryesore. Ato fokusohen në mësimdhënien, kërkimin shkencor, ndërkombëtarizimin, sigurimin e cilësisë, dimensionin social etj. KUQ synon hapjen e programeve të reja si dhe përmirësimin e atyre aktuale. Statuti (Neni 4) dhe Rregullorja (neni 34) e KUQ përcaktojnë mundësinë e ofrimit të programeve me karakter profesional. Rregullorja e Institucionit nuk raporton mbi këtë program studimi dhe GVJ sugjeron që kjo të ndryshojë. Në përgjithësi, mund të themi se programi i studimit “Kujdes Social dhe Shëndetësor” është hartuar dhe ofrohet në bazë të Statutit, Rregullores dhe Planit Strategjik.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Programi i studimit Kujdes Social dhe Shëndetësor është hapur me urdhër të MAS Nr. 408 datë 14.07.2022. Ky është një program studimi i cili fokusohet si në aspektin social ashtu dhe atë shëndetësor. Ky është një program që ofrohet nga KUQ dhe është unik për momentin në nivel kombëtar. Pavarësisht kësaj, nuk ka një studim tregu të mirëfilltë për nevojat egzakte të tregut. Autoritet drejtuese raportuan se kanë zhvilluar një studim tregu para hapjes së këtij programi por në gjykimin e GVJ, nuk është i mjaftueshëm. Dokumenti i prezantuar nga KUQ si studim tregu është më shumë në konceptin teorik dhe jo i matur me tregues direkt. Autoritetet e KUQ duhet të zhvillojnë një studim më të detajuar duke përfshirë dhe institucionet e</p>




	<p>mundshëmë ku të diplomuarit mund të punësohen, si dhe te perfshijne te dhenat zyrtare ne lidhje me nevojën e tregut te punes.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.1 Statuti i KUQ;</i> - <i>Evidenca 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit;</i> - <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit;</i> - <i>Evidenca 2.13 Studimi i tregut;</i> - <i>Takim me Drejtuesen e Njësisë Bazë.</i>
<p>Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>KUQ është një Institucion i arsimit të lartë që operon që prej vitit 2006 i licencuar me VKM Nr. 274, datë 10.05.2006. Kolegji është i akredituar më herët (VBA Nr. 52, datë 09.09.2022). Programi i studimit është hapur me Urdhër të MAS Nr. 408 datë 14.07.2022. Ambientet e Institucionit janë të përshtatshme për ofrimin e këtij programi studimi. Njësia Bazë ka në përbërjen e vet 9 staf akademik të cilët janë personell akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Nga këta, 5 janë PAE dhe 4 PAK.</p> <p>Numëri i Njësisë Bazë është në përputhje me marrëveshje specifike të MAS me KUQ. Nga 5 PAE 1 është me titullin akademik Prof. Asoc., 2 me gradën shkencore Dr. dhe 2 me Master Shkencor. Nga 4 PAK, 3 janë me gradën shkencore Dr. dhe 1 me Master Shkencor. Në dy vitet e studimit, në total 16 staf akademik janë të përfshirë në mësimdhënie. Nga këta 11 janë staf PAE dhe 5 PAK. Në vitin e parë të studimeve 11 staf akademik është i përfshirë nga të cilët 7 PAE dhe 4 PAK. Në vitin e dytë të studimeve 11 staf akademik janë të përfshirë nga të cilët 8 PAE dhe 3 PAK.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.1 Statuti i KUQ;</i> - <i>Evidenca 2.33 Të dhënat të plota për infrastrukturën;</i> - <i>Evidenca 3.5 Personeli Akademik, Ndihmës Akademik dhe Administrativ;</i> - <i>Evidenca në sistem mbi listen e personelit akademik që zhvillojnë mësim në programin e studimit "Kujdes Social dhe Shëndetësor".</i>

<p>Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor” ofrohet nga Departamenti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Rekreacionit Sportiv tek Fakultetit i Edukimit, Shkencat Sociale dhe Sportit. Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Njesisë Bazë. Kjo Njësi ofron po ashtu programin e studimit Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte. Programi i studimit nuk është ende i kodifikuar pasi ky proces nuk është përfunduar nga MAS ndërsa Institucioni ka përcjellë pranë MAS sugjerimet e veta për kodifikimin e këtij programi studimi.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i KUQ; - Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit; - Evidenca 2.7 Rregullore e Departamentit; - Evidenca 2.16 Evidenca për kodifikimin e programeve të studimit. 			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programet e studimit që ofrohen nga Kolegji Universitar “Qiriazi” (KUQ) nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Programi i studimit “Kujdes Social dhe Shëndetësor” është i hartuar dhe ofrohet nga Fakulteti i Edukimit, Shkencat Sociale dhe Sportit dhe Departamenti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Rekreacionit Sportiv. Ky program studimi ofrohet në përputhje me misionin, qëllimet dhe strategjinë e Institucionit. Autoritetet e KUQ duhet të zhvillojnë një studim më të detajuar të tregut të punës, duke përfshirë dhe institucionet e mundshme ku të diplomuarit mund të punësohen.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit,</p>	<p>KUQ ka të percaktuara në Statutin dhe Rregulloren e vet, njësitë akademike dhe administrative specifike të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim mbarëvajtjen e</p>




<p>siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>programeve të studimit, përfshirë këtu edhe programin e studimit “Kujdes Social dhe Shëndetësor”. Organigrama e Institucionit (neni 7 i statutit) përcakton Njësitë Akadematike dhe jo akademike. Secila Njësi si dhe organet e ndryshme kanë hartuar rregulloret e veta të cilat zbatojnë (sipas raportimeve në takimet e zhvilluara).</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i KUQ; - Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit; - Evidenca 1.4.1.Rregullore e Senatit - Evidenca 1.4.2.Rregullore e BA; - Evidenca 1.5.Rregullore e NJSBC; - Evidenca 1.9.Rregullore e brendshme e bibliotekës; - Evidenca 1.12.Rregullore e sekretarisë mësimore; - Evidenca 1.14.Rregullore e ZMJP&KK; - Evidenca 2.5. Rregullore e FESHSS; - Evidenca 2.7 Rregullore e Departamentit; - Takim me drejtuesin e Njesisë Bazë; - Takim me përfaqësues të Zyrës së Marrdhëniewe me Jashtë e Pranimeve dhe e Këshillimit për Karrierë; - Takim me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivit; - Takim me përfaqësues të Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;.
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Me qëllim zhvillimin e programit mësimor KUQ ka nënshkruar disa marrëveshje me Institucione brenda dhe jashtë Shqipërisë. Marrëveshjet deri në këtë moment janë të pakta dhe kjo është një pikë e dobët që Institucioni duhet të përmirësojë. Në takimin e zhvilluar me Zyrën e Marrdhëniewe me Jashtë, raportuan se kanë rreth 10 marrëveshje bashkëpunimi ndërsa 3 janë në proces. Marrëveshjet aktuale janë me IAL brenda dhe jashtë vendit, qendra shëndetësore dhe spitale si dhe Qendrën Auxil në Gjermani. Në raportin vjetor të Departamentit, raportohen vetëm tre marrëveshje bashkëpunimi për implementimin dhe zhvillimin e këtij programi studimi. GVJ konsideron se Institucioni duhet të realizoj më shumë marrëveshje bashkëpunimi për këtë program studimi.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.34. Marrëveshjet e bashkëpunimit; - Evidenca 2.9. Analiza vjetore e DESHSRS;

	<p>- <i>Takim me përfaqësues të Zyrës së Marrdhënieve me Jashtë e Pranimeve dhe e Këshillimit për Karrierë.</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>Institucioni ka nënshkruar marrëveshje specifike për realizimin e praktikës profesionale me institucione brenda dhe jashtë vendit. Pavarësisht se KUQ raporton se ka 94 Marrëveshje bashkëpunimi, pjesa më e madhe e tyre nuk janë të përshtatshme për këtë program studimi. Në raportin vjetor të Departamentit, raportohen marrëveshje bashkëpunimi me Kryqin e Kuq Shqiptar, me Qendrën Shëndetësore Kamëz si dhe Akademinë Gjermane Auxila (këto dy të fundit për praktika mësimore/profesionale). Në takimet e zhvilluara u raportua se KUQ ka dhe marrëveshje me spitalin e Traumës për praktika mësimore. Paralelisht, studentët kanë mundësinë të zhvillojnë praktikën profesionale dhe në Institucione të dëshirës së tyre, në bazë të një marrëveshje personale. Një nga studentët raportoi se kishte bërë praktikë në Spitalin Ushtarak (reparti i Kirurgjisë). Kjo u konfirmua dhe nga studentët në takimin e zhvilluar. Përmes programit Erasmus+, studentët mund të zhvillojnë praktikën e tyre në Institucione homologe jashtë vendit. Deri në këtë moment (pavarësisht së KUQ ka marrëveshje të tilla) nuk janë realizuar mobilitete për këtë program studimi. Një nga problemet kryesore për këtë çështje u raportua se është dhe mungesa e aftësive në gjuhë të huaj nga studentët. GVJ sugjeron që Institucioni të rrisi numërin e marrëveshjeve me institucione brenda dhe jashtë vendit për realizimin e praktikave profesionale.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.34. Marrëveshjet e bashkëpunimit;</i> - <i>Evidenca 2.9. Analiza vjetore e DESHSRS;</i> - <i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Bazë;</i> - <i>Takim me studentët;</i> - <i>Takim me përfaqësues të Zyrës së Marrdhënieve me Jashtë e Pranimeve dhe e Këshillimit për Karrierë.</i>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion</p>	<p>Institucioni harton rregullisht raportin vjetor. Raporti hartohet në bazë të raporteve të Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë të KUQ. Sektori i Marrdhënieve me Jashtë është përgjegjës për hartimin e raporteve të tilla. Në raportin e Njesisë Bazë bëhet një raportim sipërfaqësor dhe GVJ sugjeron që kjo të jetë më e detajuar. Pavarësisht kësaj, duhet të merret parasysh që ky është një program i ri.</p> <p>Evidenca</p>

<p>të realizimit të programit të studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.14 Rregullore e ZMJP&KK; - Evidencë 2.6 Analiza vjetore e FESHSS; - Evidenca 2.9. Analiza vjetore e DESHSRS; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Bazë; - Takim me përfaqësues të Zyrës së Marrdhënieve me Jashtë e Pranimeve dhe e Këshillimit për Karrierë.
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>KUQ raporton se mundohet të asistoj studentët për punësimin e tyre si dhe ti mbështesë ata në aspektin e sipërmarrjes. Ky është një rol që ka Zyra e Marrdhënieve me Jashtë e Pranimeve dhe e Këshillimit për Karrierë. Specialisti përgjegjës ka si detyrë të informoj maturanët nëpërmjet këshillimit të karrierës, të krijojë mundësi për realizimin e praktikave, të organizoj takime të ndryshme si dhe të ndjekë rregullisht ecurinë dhe rritjen e studentëve. Në takimin me përfaqësuesin e zyrës, u raportua se për këtë çështje Institucioni ka marrë pjesë në panairin e punës, si dhe ka ndërmarrë iniciativën “Future business idea”, në të cilin studentët zhvillojnë një trajnim specific me qëllim hartimin e një plani biznesi. Paralelisht, u raportua se zyra është gjithnjë e hapur për studentët në çdo moment që ata kanë nevojë për asistencë. Nxitja e studentëve që të jenë më aktivë është nga qëllimet kryesore të Zyrës. Studentët raportuan se nuk kanë marrë pjesë në aktivitete për punësim apo për zhvillimin e aftësive të tyre për sipërmarrjen.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.12 Raport, plan pune dhe aktivitetet vjetore për vitin akademik 2022-2023, ZMJP&KK.; - Takim me studentët; - Takim me përfaqësues të Zyrës së Marrdhënieve me Jashtë e Pranimeve dhe e Këshillimit për Karrierë.
<p>Konkluzione</p>	<p>KUQ ka në Rregulloren dhe Statutin e vet Njesisë akademike dhe administrative specifike të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim mbarvajtjen e programeve të studimit. Marrëveshjet deri në këtë moment janë të pakta për këtë program studimi dhe kjo është një pikë e dobët që Institucioni duhet të përmirësojë. Në raportin e Njesisë Bazë bëhet një raportim sipërfaqësor i përfitimit nga marrëveshjet dhe GVJ sugjeron që kjo të jetë më e detajuar. KUQ raporton se mundohet të asistojë studentët për punësimin e tyre si dhe ti mbështesë ata në aspektin e sipërmarrjes ndërsa studentët raportuan se nuk kanë marrë pjesë në takime të tilla.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>KUQ ka në përbërjen e vet Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Kjo është e parashikuar në statutin e Institucionit (neni 51) si dhe në Rregulloren e KUQ (Neni 89). NJSBC ka rregulloren e vet. Në përbërje NJSBC ka 5 anëtarë nga të cilët katër janë staf akademik (por jo autoritete drejtuese) dhe një student.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i KUQ; - Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit; - Evidenca 1.5.Rregullore e NJSBC; - Takim me përfaqësues të Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>NJSBC ka në strukturën e vet një përfaqësues të studentëve. Kjo parashikohet në Statutin e KUQ (neni 51). Nuk u raportua përfshirja e ekspertëve të jashtëm nga NJSBC. GVJ konsideron se prezenca e ekspertëve të jashtëm do të ishte një vlerë e shtuar dhe për këtë arsye sugjerojnë se rregullisht të përfshihen të tillë. NJSBC përfshihet në shumë procedura në KUQ duke kontrolluar aktet rregullatore të brendshme nëse janë në përputhje me aktet ligjore, kontrollojnë procesin e mësimdhënies (përmes pyetësorit) si dhe zhvillojnë kontrolle në orën e mësimi. GVJ konsideron se kjo e fundit duhet parë me kujdes me qëllim mos cënimin e lirisë akademike të stafit akademik. Me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, NJSBC organizon aktivitete dhe takime të ndryshme.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i KUQ; - Evidenca 1.5.Rregullore e NJSBC; - Evidenca 1.5.2 Raporti Vjetor i NJSBC;

	<p>- <i>Takim me përfaqësues të Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Raporti i NJSBC është i detajuar dhe fokusohet më shumë në aktivitetet e përgjithshme të KUQ dhe jo specifikisht në aktivitetet e sigurimit të brendshëm të cilësisë. GVJ konsideron se NJSBC duhet të hartojë një strategji vlerësimi, si dhe disa mekanizma vlerësimi për mesimdhënie, kërkimin dhe aspektet administrative. Në takimin e zhvilluar nuk u raportuan instrumenta të ndryshëm për sigurimin e cilësisë si dhe mos zhvillimin e një vlerësimi gjithëpërfshirës. Këto janë pika të dobta të cilat institucioni duhet të përmirësojë. Pavarësisht se në raportin e vet NJSBC propozon disa rekomandime, nuk u paraqit një plan konkret veprimi për adresimin e çështjeve/problematikave të ngritura. Studentët vlerësojnë rregullisht stafin akademik përmes një pyetësoari. Kjo u konfirmua edhe nga studentët. Pavarësisht kësaj, nuk ka një plan masash mbi gjetjet e pyetësorit dhe problematikat e mundshme. Në takim u raportua se nuk ka patur problematika ndërsa rezultatet i përcillen Rektorit dhe më pas Drejtuesve të Njësive Kryesore dhe Bazë. Në takimin e zhvilluar KUQ ka të përcaktuar në statutin dhe rregulloren e vet sigurimin e jashtëm të cilësisë (neni 52 i statutit dhe neni 90 i Rregullores). Institucioni është i akredituar sipas legjislacionit (VBA Nr. 52, datë 09.09.2022).</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.1 Statuti i KUQ;</i> - <i>Evidenca 1.5.Rregullore e NJSBC;</i> - <i>Evidenca 1.5.2 Raporti Vjetor i NjsBC;</i> - <i>Takim me studentët;</i> - <i>Takim me përfaqësues të Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën</p>	<p>NJSBC është në dispozicion të të gjitha Njësive akademike dhe administrative të Institucionit. KUQ zhvillon rregullisht vlerësimin e stafit akademik nga studentët përmes pyetësorit të hartuar. Në raportin vjetor të NJSBC përfshihen aktivitetet e ndryshme të realizuara si kërkimi shkencor, mësimdhënia etj. Në vlerësimin e GVJ, raporti është i nevojshëm të përfshijë dhe indikator specifik për matjen e cilësisë. Diversifikimi i instrumentave të sigurimit të cilësisë është një pikë që KUQ ka ndërtuar. Instrumenta të ndryshëm raportohet se egzistojnë në Institucion dhe kjo është një</p>

<p>promovime nxitëse për arritjet më të mira.</p>	<p>pikë e fortë. Vlerësimi i përputhshmërisë së akteve ligjore me vendimet e brendshme të KUQ realizohet, siç u raportua në takimin e zhvilluar. Një pikë e fortë që KUQ ka është hartimi i dokumentit mbi “Politikat e Vlerësimit të Brendshëm”.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.5. Rregullore e NJSBC; - Evidenca 1.5. 1 Politikat e NJSBC; - Evidenca 1.5.2 Raporti Vjetor i NJSBC; - Evidenca 1.7 Politikat e vlerësimit të brendshëm; - Evidenca 2.26 Paketa e Instrumentave për Matjen e Cilësisë; - Evidencat 2.26.1-2.26.9; - Takim me studentët; - Takim me përfaqësues të Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. 			
<p>Konkluzione</p>	<p>KUQ ka në përbërjen e vet Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). NJSBC ka në strukturën e vet një përfaqësues të studentëve. GVJ konsideron se prezenca e ekspertëve të jashtëm do të ishte një vlerë e shtuar dhe për këtë arsye sugjeron se rregullisht të përfshihen të tillë. Nuk u raportuan instrumenta të ndryshëm për sigurimin e cilësisë si dhe mos zhvillimin e një vlerësimi gjithëpërfshirës 360 gradë. Këto janë pika të dobta të cilat institucioni duhet të ndërmarrë. Diversifikimi i instrumentave të sigurimit të cilësisë është një pikë që KUQ duhet të punoj më shumë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1




Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullore.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Neni 35 i Statutit të KUQ përcakton se programet profesionale organizohen me 60 dhe 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 1 ose 2 vite akademike. Këto janë të përcaktuara dhe në Rregulloren e Njesisë Kryesore (neni 24). Ky program studimi është i organizuar në module dhe i vlerësuar në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Neni 22 i Rregullores së Institucionit përcakton se komponentët mësimor të këtij programi janë Lëndë Bazë, Lëndë Karakterizuese, Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose Integruese, Lëndë Plotësuese dhe Detyrime Përmbyllëse. Këto janë të përcaktuara dhe në Rregulloren e Njesisë Bazë (neni 14). Sipas planit mësimor të programit të studimit, veprimtaritë formuese grupohen në Lëndë Bazë (16 kredite), Lëndë Karakterizuese (63 kredite), Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose Integruese (17 kredite), Lëndë Plotësuese (18 kredite) dhe Detyrime Përmbyllëse (5 kredite). Plani mësimor (neni 8) përcakton të detajuar kreditet për secilën lëndë. Plani mësimor nuk është i përfshirë në Rregulloren e programit të studimit nuk përmenden elementet që përbëjnë strukturën e programit. GVJ konsideron se Njësia Bazë duhet të marri masa që ky informacion të përfshihet në Rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i KUQ; - Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit; - Evidenca 2.5 Rregullore e FESHSS; - Evidenca 2.7 Rregullore DESHSRS; - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor"; - Evidenca 3.3 Plani Mësimor; - Evidenca 3.4 Veprimtaria formuese e programit; - Evidenca 3.6 Programet e lëndëve (syllabuset); - Evidencat 3.6.1-3.6.18.

<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale, jep njohuri të përpunuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përpunuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p>	<p>Misioni i këtij programi studimi është ti shërbej sistemit të Kujdesit Social dhe Shëndetësor, duke formuar teknikë të lartë, që zoterojnë qëllimin, objektivat dhe kompetencat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kompetenca të mjaftueshme teorike dhe praktike të karakterit social e psikologjik, sidomos në fushën e komunikimit dhe psikologjisë së punës me të sëmurë të moshave të ndryshme, me persona me aftësi ndryshe si dhe me ata të moshës së tretë. Misioni i Kompetencave të mjaftueshme për organizimin e funksionin e gendrave të shërbimit shëndetësor dhe social si dhe të afrimit të këtij shërbimi për qytetarit; • Kompetenca teorike dhe praktike të mjaftueshme mbi shkencat shëndetësore dhe infermieristike të aplikuar, sidomos anatominë, fiziologjinë, sëmundjet kryesore të sistemeve të ndryshme të organeve, terapinë dhe kujdesin gjatë realizimit të saj, si dhe gjatë periudhës së rehabilitimit të të sëmurëve: <p>Qëllimi i studimeve të Programit të Studimit me karakter profesional në “Kujdes Social dhe Shëndetësor”, me lëndet që ofron, metodat bashkëkohore interaktive që stafi akademik përdor, u jep mundësi pjesëmarrësve që të pozicionohen qartësisht në karrierën e ardhshme. Programi i studimit ka për qëllim të përgatisë dhe të kualifikojë kandidatë për veprimtari krijuese, i cili është individual dhe duke siguruar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e programit të studimit në kontekstin e Hapësirës Europiane të Arsimit.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”; - Evidenca 3.3 Plani Mësimor; - Evidenca 3.4 Veprimtaria formuese e programit; - Evidenca 3.11 Dosja e programit me karakter profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”.
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në</p>	<p>Ky program ka për qëllim t'u mësojë studentëve kombinimin e dijeve teorike me analitike konkrete si dhe aftësinë për të zbatuar në praktikë koncepte abstrakte teorike, në mënyrë që të jenë të aftë të përshtaten, të orientohen, dhe të kenë sukses në dinamikat komplekse të tregut të punës. Në përfundim të këtij programi, studentët pajisen me njohuritë dhe aftësi praktike për të punuar në mënyrë të pavarur në fushën e Kujdesit Social dhe Shëndetësor. Objektivi kryesor i këtij</p>




<p>përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>programi studimi është formimi i teknikëve të lartë në fushën e kujdesit social dhe shëndetësor. Programet e lëndëve të këtij programi studimi synojnë thellimin, zgjerimin dhe specializimin e njohurive teorike dhe aftësive për shërbime shëndetësore dhe sociale. Në fokusin e tij te plotë, ky program studimi gërsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar tek studenti mendimin kritik dhe krijues, si edhe për t'i ekspozuar ata drejt çështjeve me rëndësi në fushën sociale dhe shëndetësore nëpërmjet një modeli mësimi të mbështetur nga praktika profesionale në këto fusha. Misioni dhe objektivat specifike të programit të studimit duhet të përfshihen në Rregulloren e programit të studimeve.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor"; - Evidenca 3.3 Plani Mësimor; - Evidenca 3.4 Veprimtaria formuese e programit; - Evidenca 3.11 Dosja e programit me karakter profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor".
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit ka në total 120 kredite të ndara në dy vite akademike (60 kredite në vit ose 30 kredite për semestër). Të gjitha lëndët/modulet kanë të parashikuara kredite. Sipas përcaktimeve, Lëndët Bazë kanë 16 kredite, Lëndët Karakterizuese 63 kredite, Lëndët ndërdisiplinore dhe/ose Integruese 17 kredite, Lëndët Plotësuese 18 kredite dhe Detyrime Përmbyllëse 6 kredite. Secila lëndë ka një numër të caktuar kreditesh që varjon nga 5 ECTS deri në 9 ECTS. Për përfundimin e studimeve, është parashikuar provimi përfundimtar i cili ka gjashtë (6 ECTS) kredite. Po ashtu, praktika profesionale është e përfshirë dhe ka 12 kredite në total.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor"; - Evidenca 3.3 Plani Mësimor; - Evidenca 3.4 Veprimtaria formuese e programit.
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në</p>	<p>Ky nuk është një Institucion i Arsimit të Lartë me status të veçantë.</p>

<p>përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>				
<p>Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Gjatë hartimit të këtij programi studimi janë marrë parasysh programe të ngjashme në Gjermani dhe më specifikisht, ato që ofrohen nga Akademia Auxile. Kjo u raportua nga Drejtuesia e Njesisë Bazë gjatë takimit të zhvilluar. Qëllimi është që të diplomuarit të kenë Rolin e Kujdestarit. Paralelisht, KUQ ka depozituar pranë ASCAL dhe MAS propozimet përkatëse për këtë program studimi.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.16 Të dhëna për kodifikimin e programeve të studimit në FESHSS; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Bazë. 			
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Kodifikimi i programit të studimit nuk është ende përfunduar nga MAS. KUQ ka bërë kodifikimin sipas udhëzimit të MAS. Në përfundim të këtij procesi, do të zhvillohet dhe kodifikimi i lëndëve.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.16 Të dhëna për kodifikimin e programeve të studimit në FESHSS; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Bazë. 			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Ky program studimi është i organizuar në module dhe i vlerësuar në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Komponentët mësimor të këtij programi janë Lëndë Bazë, Lëndë Karakterizuese, Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose Integruese, Lëndë Plotësuese dhe Detyrime Përmbyllëse. Misioni i këtij programi studimi është ti shërbej sistemit të Kujdesit Social dhe Shëndetësor. Misioni dhe objektivat specifike të programit të studimit duhet të përfshihen në Rregulloren e programit të studimeve. Secila lëndë ka një numër të caktuar kreditesh që varjon nga 5 ECTS deri në 9 ECTS. Për përfundimin e studimeve, është parashikuar provimi përfundimtar i cili ka gjashtë (6 ECTS) kredite. Po ashtu, praktika profesionale është e përfshirë dhe ka 12 kredite në total.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>




				X
--	--	--	--	---

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>KUQ është një Institucion i arsimit të lartë që operon që prej vitit 2006 i liçensuar me VKM Nr. 274, datë 10.05.2006. Universiteti është i akredituar më herët (VBA Nr. 52, datë 09.09.2022). Programi i studimit është hapur me urdhër nga MAS Nr. 408 datë 14.07.2022.</p> <p>Njësia Bazë ka në përbërjen e vet gjithsej 9 staf akademik, nga këta, 5 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 4 staf akademik me kontratë (PAK). Numëri i Njësisë Bazë vjen si pasojë e një marrëveshje specifike të MAS me KUQ.</p> <p>Nga 5 PAE:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 me Prof. Asoc; - 2 me Dr; - 2 me Msc; <p>Nga 4 PAK:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 me Dr; - 1 me Msc; <p>Në dy vitet e studimit, në total 16 staf akademik janë të përfshirë në mësimdhënie. Nga këta 11 janë staf PAE dhe 5 PAK. Në vitin e parë të studimeve 11 staf akademik është i përfshirë nga të cilët 7 PAE dhe 4 PAK. Në vitin e dytë të studimeve 11 staf akademik janë të përfshirë nga të cilët 8 PAE dhe 3 PAK.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Sportit ku ofrohet dhe programi i studimit me karakter profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”, ka në përbërjen e vet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve; - Departamenti i Edukimit, Shkenca Sociale dhe Rekreacionit Sportiv; - Qendra Kërkimore –Shkencore; <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i KUQ;

	<ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.5 Personeli Akademik, Ndhimës Akademik dhe Administrativ; - Evidenca në sistem mbi listen e personelit akademik që zhvillojnë në programin e studimit “Kujdes Social dhe Shëndetësor”.
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Neni 31 i Statutit të KUQ parashikon personelin ndihmës akademik si me karakter mësimor ashtu dhe me karakter administrativ. Institucioni ka në përbërjen e vet staf ndihmës akademik me karakter administrativ. Në takimin me përfaqësuesin e Burimeve Njerëzore u raportua se nuk ka staf ndihmës akademik me karakter mësimor. Laboratorët zhvillohen nga stafi akademik i Njesisë Bazë. GVJ konsideron si të rëndësishme që KUQ të ketë në përbërje edhe staf ndihmës akademik me karakter mësimor.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i KUQ; - Evidenca 3.5 Personeli Akademik, Ndhimës Akademik dhe Administrativ; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Bazë; - Takim me përfaqësues të Sektorit të Burimeve Njerëzore.
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Institucioni ka caktuar një person në rolin e kordinatorit të programit të studimit. Ai është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit. Drejtuesia e Njesisë Bazë raportoi se roli i koordinatorit është të merret me problematikat e ndryshme, informon studentët për sallat dhe për çështje të tjera. Koordinatori po ashtu informon dhe studentët e rinj. Studentët raportuan se e njohin koordinatorin e programit të studimit por nuk dinë rolin e skt të tij. Ata raportuan se kanë mbështetje më të lart nga Drejtuesia e Njesisë Bazë. GVJ konsideron se roli i koordinatorit dhe detyrat e tij duhet të përfshihen në Rregulloren e Njesisë Bazë.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.15 Vendimi për caktimin e Koordinatorit të programit të studimit; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Bazë; - Takim me studentët.
<p>Konkluzione</p>	<p>Njësia Bazë ka në përbërjen e vet 5 staf akademik PAE nga të cilët 1 është me titullin akademik Prof. Asoc., 2 me gradën shkencore Dr. dhe 2 me Master Shkencor. Në takimin me</p>

	<i>përfaqsesin e Burimeve Njerëzore u raportua se nuk ka staf ndihmës akademik me karakter mësues. Institucioni ka caktuar një person në rolin e kordinatorit të programit të studimit. Ai është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Dokumentacioni i nevojshëm për ofrimin e këtij programi studimi është i disponueshëm nga Njësia Bazë. Statuti dhe Rregullorja e Institucionit përcaktojnë rregullat e përgjithshme ndërsa me më shumë informacione për këtë program studimi me karakter profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor” paraqiten në Rregulloren e Njesisë Kryesore, Njesisë Bazë dhe në rregulloren e programit të studimit. Informacion mbi këtë program përfshihet edhe në dokumentin Evidenca 3.11 Dosja e programit me karakter profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”. Në takimin e zhvilluar me Drejtuesin e Njesisë Bazë u raportua se i gjithë dokumentacioni është i disponueshëm pranë Njesisë përfshirë rregulloren, planin mësues si dhe syllabuset. Literatura bazë gjendet në bibliotekën e Institucionit si dhe në kancelari.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i KUQ; - Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit; - Evidenca 2.5 Rregullore e FESHSS; - Evidenca 2.7 Rregullore DESHSRS; - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”; - Evidenca 3.11 Dosja e programit me karakter profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”; - Takim me Drejtuesin e Njesisë Bazë.

Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.

Ky është një program me karakter profesional dhe ka në total 120 kredite (ECTS). Plani mësimor përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra si dhe ngarkesën mësimore. Lëndët janë të ndara në dy vite akademike. Një kredit është i barabartë me 20-25 orë ndërsa orët total në vit janë 1500. Të gjitha lëndët/modulet kanë të parashikuara kredite. Sipas përcaktimeve, Lëndët Bazë kanë 16 kredite, Lëndët Karakterizuese 63 kredite, Lëndët ndërdisiplinore dhe/ose Integruese 17 kredite, Lëndët Plotësuese 18 kredite dhe Detyrime Përmbyllëse 6 kredite. Plani mësimor përcakton të detajuar kreditet për secilën lëndë. **Plani mësimor nuk prezanton nr. e provimeve dhe orët jashtë auditorit (punë e pavarur e studentit)**, ndërsa kreditet, ndarja e orëve në kredite, ndarja e orëve në semestër dhe totalin e orëve në auditor janë prezantuar. Në çdo semestër, numëri total i mundshëm i krediteve është 60 ECTS. **GVJ vëren se lëndët Bazë zhvillohen në semestrin e dytë dhe jo të parë. Paralelisht, në planin mësimor nuk janë të qarta orët laboratorike, ushtrimet si dhe praktika profesionale pasi ato janë vendosur bashkë (ushtrime/praktikë dhe laborator/praktikë).** Në takimin me Drejtuesen e Njesisë Bazë u raportua se qëllimi i tyre është përmirësimi i programit duke përfshirë edhe lëndë të sportit (lëndë fizike).

Kujdes Social dhe Shëndetësor	Viti I	Viti II	Në total
Në auditor	610	625	1235
Leksione	280	225	505
Seminare	190	87	277
Ushtrime/Praktika	85	45	130
Laboratore/Praktika	50	268	318
Punë e pavarur e studentit	890	872	1762
Gjithsej	1500	1500	3000

Evidenca

- Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor";
- Evidenca 3.3 Plani Mësimor;
- Evidenca 3.4 Veprimtaria formuese e programit;

	<p>- <i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Bazë.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Neni 36 i statutit të KUQ përcakton se çdo shtetas shqiptar që ka përfunduar me sukses Maturën Shtetërore, ka të drejtë të kandidojë për t'u pranuar. Në regjistrimin e studentëve zbatohet legjislacioni në fuqi ndërsa pranimi i kandidatëve bëhet në mbështetje të kapaciteteve dhe kuotave të miratuara dhe të pranuar. Këto janë të prfshira dhe në Rregulloren e Njesisë Kryesore (neni 33) si dhe në Rregulloren e Programit të studimit (neni 7). Pranimi bëhet në bazë të kuotave të miratuara nga Departamenti dhe të miratuara më tej nga Dekani, Rektori dhe MAS. Nuk përcaktohen në rregulloren e programit kritere të përgjithshme apo specifike për pranimin të tjera. Transferimi i studimeve është i mundur dhe parashikohet në nenin 42 të Statutit, neni 68 i Rregullores së KUQ, neni 81 i Rregullores se Njesisë Kryesore dhe neni 60 i Rregullores së Njesisë Bazë. Ekuivalentimi i studimeve parashikohet në nenin 42 të Statutit, neni 67 i Rregullores së Institucionit, neni 79 i Njesisë Kryesore dhe nenet 58-59 të Njesisë Bazë.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.1 Statuti i KUQ;</i> - <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit;</i> - <i>Evidenca 2.5 Rregullore e FESHSS;</i> - <i>Evidenca 2.7 Rregullore DESHSRS;</i> - <i>Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor".</i>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Plani mësimor përben dokumentacionin kryesor me karakter të gjerë informativ, në të cilin paraqiten elementët si 1) Kreditet për çdo veprimtari formuese, shpërndarja e krediteve brenda një disipline sipas komponenteve mësimorë të saj (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara ne auditor; studim e punim relacionesh, detyrash apo projektsh përgatitje për provime; përgatitje e tezës së diplomës; veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private.) 2) Periudha dhe mënyra e kontrollit të dijeve 3) Modalitetet e tezës së diplomës/ provimit të formimit. Programi i lëndës/Modulit (Syllabusi) pasqyron përshkrimin e lëndës/modulit- objektivat, kërkesat, procedurat, detyrimet e studentit, mënyrën e vlerësimit të</p>

	<p>tyre, përmbajtjen e programit të modulit sipas temave, literaturën e rekomanduar, etj. (Aneksi 3). Programi i Lendes/Modulit hartohet nga pedagogu, miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani i Fakulteti përkatës. Ai është dokument zyrtar e ligjore dhe si i tillë i detyrueshëm për zbatim. Kjo procedurë u konfirmua dhe nga Drejtuesia e Njesisë Bazë si dhe stafi akademik. Të gjitha këto janë të parashikuara në nenin 45-46 të Rregullores së Institucionit, neni 30 i Njesisë Kryesore, dhe neni 15 i Rregullores së Njesisë Bazë. GVJ sugjeron që informacioni mbi syllabuset të përfshihet dhe në Rregulloren e programit të studimeve.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i KUQ; - Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit; - Evidenca 2.5 Rregullore e FESHSS; - Evidenca 2.7 Rregullore DESHSRS; - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor"; - Evidenca 3.6 Programet e lëndëve (syllabuset); - Evidencat 3.6.1-3.6.18; - Takim me Drejtuesin e Njesisë Bazë; - Takim me stafin akademik.
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</p>	<p>Përmirësimi i programeve në KUQ zhvillohet rregullisht në fillim të vitit akademik. Kjo u konfirmua dhe në takimet me Drejtuesin e Njesisë Bazë si dhe me stafin akademik. Duke patur parasysh që ky është një program i ri studimi dhe brezi i parë do të diplomohet këtë vit, nuk janë bërë përmirësime ende. Në takimin me Drejtuesin e Njesisë Bazë u raportua se qëllimi i tyre është përmirësimi i programit duke përfshirë edhe lëndë të sportit (lëndë fizike).</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takim me Drejtuesin e Njesisë Bazë; - Takim me stafin akademik.
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Dokumentacioni i nevojshëm për ofrimin e këtij programi studimi është i disponueshëm nga Njësia Bazë. Plani mësimor përcakton të detajuar kreditet për secilën lëndë. Plani mësimor nuk prezanton nr. e provimeve dhe orët jashtë auditorit (punë e pavarur e studentit), ndërsa kreditet, ndarja e orëve në kredite, ndarja e orëve në semestër dhe totalin e orëve në auditor janë prezantuar. GVJ vëren se lëndët Bazë zhvillohen në semestrin e dytë dhe jo</i></p>




	<p><i>të parë. Paralelisht, në planin mësimor nuk janë të qarta orët laboratorike, ushtrimet si dhe praktika profesionale pasi ato janë vendosur bashkë (ushtrime/praktikë dhe laborator/praktikë). Pranimi bëhet në bazë të kuotave të miratuara nga Departamenti dhe të miratuara më tej nga Dekani, Rektori dhe MAS. Programi i Lendes/Modulit hartohet nga pedagogu, miratohet nga Përgjegjësi i Dedepartamentit dhe Dekani i Fakulteti përkatës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</p>	<p>Studentët përmes dy viteve akademike kanë mundësinë të thellojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre, të pajisen me aftësi praktike me qëllim aftësimin e tyre për punësim në fushën e kujdesit social dhe shëndetësor. Në total studentët zhvillojnë 15 lëndë si dhe praktikën profesionale. Në përfundim të studimeve, të diplomuarit kanë mundësi të ofrojnë shërbime për fëmijë, të rinj, të rritur si dhe të moshuar. Kjo u jep atyre mundësinë të fitojnë aftësi për të shërbyer si kujdestar të grupeve në nevoj. Studentët në takimin e zhvilluar raportuan se ndihen të aftë për të ofruar shërbime dhe se disa prej tyre e kanë zgjedhur këtë program studimi për tu ofruar ndihmë/kujdes disa nga familjarëve të tyre të cilët kanë probleme të ndryshme shëndetësore. GVJ në diskutimet që zhvilloi me stafin akademik dhe studentët vërejti se në disa raste u raportuan marrje e njohurive/aftësive mbi kompetencave që të diplomuarve u lejohet.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.4 Veprimtaria formuese e programit; - Evidenca 3.11 Dosja e programit me karakter profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor" - Takim me Drejtuesin e Njesisë Bazë; - Takim me studentët.

<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Programi i studimit përmban Lëndët Bazë (16 kredite), Lëndët Karakterizuese (63 kredite), Lëndët ndërdisiplinore dhe/ose Integruese (17 kredite), Lëndët Plotësuese (18 kredite) dhe Detyrime Përmbyllëse (6 kredite). Secila lëndë ka një numër të caktuar kreditesh që varjon nga 5 ECTS deri në 9 ECTS. Për përfundimin e studimeve, është parashikuar provimi përfundimtar i cili ka gjashtë (6 ECTS) kredite. Ka një ndërthurje të lëndëve të përgjithshme me lëndët më specifike. Ato janë të shpërndara në vite e semestra dhe mundësojnë formimin profesional të studentëve. Plani mësimor mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Plani mësimor është i ndarë në lëndë/module me kredite specifike (120 kredite në total). Në syllabuset e lëndëve përcaktohen kreditet dhe orët brenda auditorit. Plani mësimor nuk prezanton nr. e provimeve dhe orët jashtë auditorit (punë e pavarur e studentit). GVJ vëren se lëndët Bazë zhvillohen në semestrin e dytë dhe jo të parë. Paralelisht, në planin mësimor nuk janë të qarta orët laboratorike, ushtrimet si dhe praktika profesionale pasi ato janë vendosur bashkë (ushtrime/praktikë dhe laborator/praktikë). GVJ sugjeron që plani mësimor të përditësohet duke bërë rregullimet e nevojshme. Këto u diskutuan dhe në takimin me drejtuesin e Njesisë Bazë e cila konfirmoj dëshirën e tyre për përditësimin e programit. Studentët në takimin e zhvilluar raportuan se do të dëshironin të kishin më edhe lëndë psikosociale.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”;</i> - <i>Evidenca 3.3 Plani Mësimor;</i> - <i>Evidenca 3.4 Veprimtaria formuese e programit.</i> - <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Bazë;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësisimit në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>Në diskutimet në KUQ, u raportua se ky program është i ngjashëm me programe të tjera jashtë vendit (Akademinë Gjermane Auxila). Në total ky program për dy vite akademike kërkon angazhimin për 3000 orë (1235 brenda në auditor dhe 1762 jashtë). Programi përfshin teori dhe praktikë. Syllabuset e lëndëve pasqyrojnë qartë orët teorike dhe praktike që duhet të ndjekin studentët. Në total studentët zhvillojnë 505 orë leksione, 277 orë seminare, 220 orë praktikë. Praktika ka në total 12 kredite. Kjo nuk arrin 25%</p>

<p>Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>e cila duhet ti dedikohet praktikës profesionale. GVJ e konsideron këtë si një pikë të dobët të cilën Institucioni duhet ta rregulloj.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.3 Plani Mësimor; - Evidenca 3.4 Veprimtaria formuese e programit. - Takim me Drejtuesen e Njesisë Bazë; - Takim me GVB.
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Plani mësimor është i ndarë në lëndë bazë (16 kredite), lëndë karakterizuese (63 kredite), Lëndë ndërdisiplinore/integruese (17 kredite), lëndë plotësuese (18 kredite) dhe detyrime përmbyllëse (6 kredite). Mënyra e ndarjes u jep mundësinë studentëve të arrijnë objektivat formuese të tyre por edhe të transferojnë studimet e tyre si dhe të punësohen. Në takimin me studentët u raportua që asnjë nga ata nuk kishte zhvilluar transferim të studimeve (këtë e konfirmoj dhe sekretaria mësimore) ose mobilitet afatshkurtër. Kjo është një pikë ku më shumë përpjekje janë të nevojshme për tu bërë nga KUQ. Dëshira e studentëve për të zhvilluar mobilitete jashtë Shqipërisë u konfirmua nga GVB të cilët thanë që kjo është një pikë ku Institucioni duhet të punoj më shumë. Përmirësimi i kurrikulës u raportua si një objektiv dhe nga Drejtuesia e Njesisë Bazë.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.3 Plani Mësimor; - Evidenca 3.4 Veprimtaria formuese e programit. - Takim me Drejtuesen e Njesisë Bazë; - Takim me studentët; - Takim me sekretarinë mësimore; - Takim me GVB.
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p>Programi i Lendes/Modulit hartohet nga pedagogu, miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani i Fakulteti përkatës. Ai është dokument zyrtar e ligjore dhe si i tillë i detyrueshëm për zbatim. Kjo procedurë u konfirmua dhe nga Drejtuesia e Njesisë Bazë si dhe stafi akademik. Të gjitha këto janë të parashikuara në nenin 45-46 të Rregullores së Institucionit, neni 30 i Njesisë Kryesore, dhe neni 15 i Rregullores së Njesisë Bazë. Procedura e hartimit të syllabusit u konfirmua dhe në takimin e zhvilluar me Drejtuesen e Njesisë Bazë dhe stafin akademik. Syllabuset e dorëzuara janë konform legjislacionit në fuqi. Informacion</p>

	<p>mbi literaturën bazë dhe atë të rekomanduar është e përfshirë. Syllabuset përditësohen në fillim të vitit akademik dhe miratohen në Departament u raportua nga stafi akademik dhe Drejtuesi i Njesisë Bazë. Studentët informohen mbi syllabuset e lëndëve dhe në javën orientuese u raportua nga stafi akademik.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.1 Statuti i KUQ; - Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit; - Evidenca 2.5 Rregullore e FESHSS; - Evidenca 2.7 Rregullore DESHSRS; - Evidenca 3.6 Programet e lëndëve (syllabuset); - Evidencat 3.6.1-3.6.18; - Takim me Drejtuesin e Njesisë Bazë; - Takim me stafin akademik.
<p>Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Praktika përfshihet në planin mësimor. Përmes praktikës studentët marrin njohuri, aftësi dhe kompetenca të cilat mund ti përdorin. Formimi praktik është i përshtatshëm për tregun e punës por GVJ konsideron se nuk është i mjaftueshëm. Orët e praktikës në konsideratën e GVJ duhet të rriten. Bahkëpunimet me punëdhënësit duhet të jenë më të ngushta me qëllim aftësimin e studentëve në bazë të nevojave të tregut. Drejtuesia e Njesisë Bazë raportoi se në fillim dhe para hapjes së këtij programi u konsultuan me punëdhënës të mundshëm. Paralelisht, rritja e bashkëpunimeve me punëdhënësit do tu japi mundësinë studentëve të zhvillojnë intershipe. Bashkëpunimi me IAL jashtë Shqipërisë në kuadër të Erasmus+ është një mundësi e mirë për Institucionin për intershipe të studentëve. Anëtarë të GVB raportuan se studentët kanë dëshirë për të zhvilluar mobilitete jashtë Shqipërisë si dhe rritje të orëve të praktikës dhe të bashkëpunimeve.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.3 Plani Mësimor; - Evidenca 3.6 Programet e lëndëve (syllabuset); - Evidencat 3.6.1-3.6.18; - Evidenca 3.8 Dosja e praktikave viti akademik 2023-2024; - Takim me Drejtuesin e Njesisë Bazë; - Takim me GVB.
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit</p>	<p>Programi i studimit u jep mundësinë studentëve të fitojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca për tregun e punës. Programet</p>




<p>garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>	<p>lëndore përcaktojnë objektivat si dhe njohuritë që studentët pritet të marrin në përfundim të studimeve. Objektivi kryesor i programit me karakter profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor" është t'u japë studentëve njohuritë e nevojshme për formimin e tyre në sektorin e kujdesit social dhe shëndetësor. Programi synon dhënien e një sërë njohurish në formimin e përgjithshëm teorik dhe praktik në fushën e kujdesit social dhe shëndetësor me objektivi kryesor formimin e koncepteve bazë. Për realizimin e këtij objektivi programi parashikon harmonizimin e njohurive, duke filluar me ato bazë teorike të fushës, duke vijuar në thellimin në fushat e anatomisë, ushqimit, sociologjisë, psikologjisë, higjienës etj. Programi synon të plotësojë nevojën që ka në tregun e punës për profesionin e kujdesit social dhe shëndetësor, duke përgatitur teknikë të lartë në fushën sociale dhe shëndetësore. Në përfundim të studimeve, studentët mund të punojnë në kujdesin e fëmijëve, të rinjve dhe të moshuarve në qendra të ndryshme shëndetësore dhe rehabilituese.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.3 Plani Mësimor; - Evidenca 3.6 Programet e lëndëve (syllabuset); - Evidencat 3.6.1-3.6.18; - Evidenca 3.11 Dosja e programit me karakter profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor". 			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në total studentët zhvillojnë 15 lëndë si dhe praktikën profesionale. GVJ vëren se lëndët Bazë zhvillohen në semestrin e dytë dhe jo të parë. Paralelisht, në planin mësimor nuk janë të qarta orët laboratorike, ushtrimet si dhe praktika profesionale pasi ato janë vendosur bashkë (ushtrime/praktikë dhe laborator/praktikë). Praktika ka në total 12 kredite. Kjo nuk arrin 25% e cila duhet ti dedikohet praktikës profesionale. Orët e praktikës në konsideratën e GVJ duhet të rriten. Bahkëpunimet me punëdhënësit duhet të jenë më të ngushta me qëllim aftësimin e studentëve në bazë të nevojave të tregut.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Gjatë hartimit të programit të studimit “Kujdes Social dhe Shëndetësor”, institucioni përdori si model Akademinë Gjermane Auxila. Paralelisht, u konsultuan me institucione të ndryshme brenda Shqipërisë si dhe punëdhënës potencial (psh Qendrat Residenciale të të moshuarve etj.). Përmirësime nuk janë bërë për këtë program studimi pasi sivjet është viti i parë që do të diplomohen studentët. Kontakt i vazhdueshëm me alumni u raportua se do të mbahet nga instancat përkatëse dhe se do ti përfshin ata në përshtatjen sa më të mirë të programit të studimit. GVJ konsideron se bashkëpunimi me punëdhënësit duhet të jetë i vazhdueshëm dhe të konkretizohet me marrëveshje specifike.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.13 Studimi i Tregut “Mbi hapjen e programit të studimeve”; - Takim me Drejtuesin e Njesisë Bazë; - Takim me GVB; - Takim me përfaqësues të Zyrës së Marrdhënieve me Jashtë e Pranimeve dhe e Këshillimit të Karrierës.
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni mban kontakte të vazhdueshme me Këshillin studentor dhe nevojat e tyre. Studentët raportuan se përmes senatorëve të grupeve raportojnë dëshirat e tyre. Ata raportuan se nuk janë përfshirë në procesin e përmirësimit të programit por në rastet që kanë pakënaqsi i shprehin ato. Një nga propozimet e studentëve ishte përfshirja e një lënde psikosociale. Institucioni raportoi se do të mbaj kontakte të vazhdueshme me të diplomuarit.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4.3 Rregullore e Këshillit Studentor; - Takim me Drejtuesin e Njesisë Bazë; - Takim me studentët; - Takim me përfaqësues të Zyrës së Marrdhënieve me Jashtë e Pranimeve dhe e Këshillimit të Karrierës.
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në</p>	<p>Hapa të tilla nuk janë zhvilluar deri në këtë moment pasi ky është një program i ri studimi dhe ende nuk janë diplomuar student. Institucioni raportoi se do të ketë bashkëpunime të</p>




përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.	ngushta me rrjete profesionistësh dhe në bazë të zhvillimeve të fushës do të përshtasë dhe përditësoj programin e studimit. Evidenca - Takim me Drejtuesin e Njesisë Bazë; - Takim me përfaqësues të Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.			
Konkluzione	<i>Gjatë hartimit të programit të studimit “Kujdes Social dhe Shëndetësor”, institucioni përdori si model Akademinë Gjermane Auxila. Përmirësime nuk janë bërë për këtë program studimi pasi sivjet është viti i parë që do të diplomohen studentët. Studentët raportuan se përmes senatorëve të grupeve raportojnë dëshirat e tyre. Një nga propozimet e studentëve ishte përfshirja e një lënde psikosociale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet,	Rregullorja Institucionit (neni 49), e Njesisë Kryesore (neni 43) dhe rregullorja e Njesisë Bazë (neni 17) përcaktojnë qartë format e mësimdhënies. Puna mësimore me studentët përfshin një larmi formash të mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kontrollit të dijeve. Keto forma parashikohen në planet mësimore, programet e moduleve, dhe rregulloren mësimore të programit të studimit. Format e mësimimit teorik e praktik janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike,

<p>praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, etj. Në përfundim të secilës lëndë/modul është parashikuar zhvillimi i provimit përkatës. Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore: Lëndë/modul tëdetyruara dhe Lëndë/modul me zgjedhje. Këto forma janë të parashikuara dhe në syllabuset prkatëse si dhe u konfirmuan në takimet me stafin akademik dhe studentët.</p> <table border="1" data-bbox="651 465 1378 987"> <thead> <tr> <th>Kujdes Social dhe Shëndetësor</th> <th>Viti I</th> <th>Viti II</th> <th>Në total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Në auditor</td> <td>610</td> <td>625</td> <td>1235</td> </tr> <tr> <td>Leksione</td> <td>280</td> <td>225</td> <td>505</td> </tr> <tr> <td>Seminare</td> <td>190</td> <td>87</td> <td>277</td> </tr> <tr> <td>Ushtrime/Praktika</td> <td>85</td> <td>45</td> <td>130</td> </tr> <tr> <td>Laboratore/Praktika</td> <td>50</td> <td>268</td> <td>318</td> </tr> <tr> <td>Punë e pavarur e studentit</td> <td>890</td> <td>872</td> <td>1762</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>1500</td> <td>1500</td> <td>3000</td> </tr> </tbody> </table> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit; - Evidenca 2.5 Rregullore e FESHSS; - Evidenca 2.7 Rregullore DESHSRS; - Evidenca 3.6 Programet e lëndëve (syllabuset); - Evidencat 3.6.1-3.6.18; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët. 	Kujdes Social dhe Shëndetësor	Viti I	Viti II	Në total	Në auditor	610	625	1235	Leksione	280	225	505	Seminare	190	87	277	Ushtrime/Praktika	85	45	130	Laboratore/Praktika	50	268	318	Punë e pavarur e studentit	890	872	1762	Gjithsej	1500	1500	3000
Kujdes Social dhe Shëndetësor	Viti I	Viti II	Në total																														
Në auditor	610	625	1235																														
Leksione	280	225	505																														
Seminare	190	87	277																														
Ushtrime/Praktika	85	45	130																														
Laboratore/Praktika	50	268	318																														
Punë e pavarur e studentit	890	872	1762																														
Gjithsej	1500	1500	3000																														
<p>Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Stafi akademik përdor mënyra dhe metoda të ndryshme gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ata përdorin matëriale në PoëerPoint, video, aktivitete në terren, simulime etj. Një nga stafi akademik raportoi se është mundur të trajnoj studentët për dhënien e ndihmës së parë dhe në përdorimin e defibrilatorit. Përdorimi i disa platformave on-line si GoogleClasroom u raportua nga stafi akademik. Metodatat e raportuara nga stafi akademik, u konfirmuan dhe nga studentët.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.19 Udhëzues për përdorimin e platformave on-line; 																																




	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Me qëllim përmirësimin e aftësive didaktike të stafit akademik, KUQ organizon rregullisht trajnime. Drejtuesia e Njesisë Bazë raportoi se trajnimi i fundit për këtë çështje është zhvilluar në fund të Dhjetorit dhe se trajnime të tjera janë planifikuar për periudhën në vijim. Zhvillimin e trajnimeve e konfirmoi dhe stafi akademik. GVJ vëren se stafi akademik nuk ka zhvilluar mobilitete jashtë Shqipërisë me qëllim mësimdhënien ose trajnimin. Kjo është diçka shumë e nevojshme dhe do të përmirësojë aftësitë dhe kompetencat didaktike.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 2.37 Lista e trajnimeve;</i> - <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Bazë;</i> - <i>Takim me stafin akademik.</i>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Stafi akademik konfirmoi se përdor metoda interaktive gjatë mësimdhënies dhe se qëllimi i tyre është mësimdhënia me në qendër studentin. Studentët konfirmuan këtë më lart. Paralelisht, studentët përmes pyetësorit të përdorur për vlerësimin e mësimdhënies kanë mundësi të shprehin lirshëm mendimet dhe idetë e tyre. Respektimi i kodit të etikës është një nga detyrimet kryesore si të stafit akademik ashtu edhe të studentëve. Stafi akademik është kompetent dhe ka aftësitë e nevojshme për mësimdhënien. Studentët shprehën konsiderata të larta për stafin akademik.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 1.8 Rregullore e Këshillit të Etikës;</i> - <i>Evidenca 3.5 Personeli Akademik, ndihmës akademik dhe administrative;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët;</i> - <i>CV pjesa 1;</i> - <i>CV pjesa 2;</i> - <i>CV pjesa 3.</i>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë</p>	<p>Studentët vlerësojnë rregullisht stafin akademik/procesin e mësimdhënies përmes pyetësorit që ata plotësojnë (2 herë në vit). Pyetësori organizohet nga NJSBC dhe përfshin të gjithë studentët e programit të studimit. Zhvillimi i pyetësorit u konfirmua nga stafi akademik, studentët dhe NJSBC. Në përfundim të pyetësorit, hartohet një raport i cili i përcillet</p>

<p>periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Rektorit dhe nga ai Drejtuesve të Njësive Kryesore dhe Bazë. Nuk u raportuan të jenë shprehur problematika të ndryshme nga studentët ndërsa GVJ-së nuk ju vu në dispozicion ndonjë plan masash specifik mbi rezultatet e pyetësorit. Vlerësimi i stafit akademik nga studentët parashikohet dhe në Rregulloren e Njesisë Bazë (neni 24). Drejtuesia e Njesisë Bazë në takimin e zhvilluar tha se nuk kanë patur problematika apo komente negative për momentin.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.5 Rregullore e NJSBC; - Evidenca 2.26.1 Model template, Pyetësori i studentit; - Evidenca 2.7 Rregullore DESHSRS; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët; - Takim me përfaqësues të Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>KUQ organizon rregullisht trajnime për stafin akademik për didaktikën. Kjo u konfirmua në takimet e zhvilluara. NJSBC është struktura në nivel Institucional që fokusohet në përmirësimin e mësimdhënies. NJSBC vlerëson veprimtarinë mësimore përmes kontrolleve, komunikimit me studentët, pasurimit të CV-ve të stafit akademik si dhe pasurimit të literaturës së syllabuseve. Pavarësisht këtyre, Institucioni nuk ka hartur ndonjë udhëzues specifik për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Kjo është një pikë që KUQ duhet të punoj më shumë.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.5 Rregullore e NJSBC; - Evidenca 2.37 Lista e trajnimeve; - Takim me stafin akademik; - Takim me përfaqësues të Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Format e mësimin teoretik e praktik janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, etj. Stafit akademik përdor mënyra</i></p>

	<i>dhe metoda të ndryshme gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies. GVJ vëren se stafi akademik nuk ka zhvilluar mobilitete jashtë Shqipërisë me qëllim mësimdhënien ose trajnimin. Stafi akademik konfirmoi se përdor metoda interaktive gjatë mësimdhënies dhe se qëllimi i tyre është mësimdhënia me në qendër studentin. Studentët vlerësojnë rregullisht stafin akademik/procesin e mësimdhënies përmes pyetësorit që ata plotësojnë (2 herë në vit).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri I. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në nenet 55-57 të Rregullores së KUQ përcaktohen me detaje kriteret dhe mënyrat e vlerësimit/kontrollit të dijeve. Nenet 51-53 të Rregullores së Njesisë Kryesore dhe nenet 30-33 të Rregullores së Departamentit. Në Rregulloren e programit të studimit, neni 17, parashikohen format e kontrollit të dijeve. Kontrolli i dijes se një lëndë zhvillohet me testimin e ndërmjetëm dhe provimin përfundimtar që bëhet me shkrim. Tezat e testimit/provimit të ndërmjetëm e përfundimtar hartohen nga titullari lëndes/pedagogu në bashkërendim me asistentin e tii (aty ku ka) dhe nënshkruhen prej tij, e miratohen nga drejtuesi i departamentit. Për vlersimin e studentit përdoret sistemi pikëzimit me 100 pikë. Ky vlersim me pikë bëhet për çdo zë perberës të vlersimit të vazhduar dhe përfundimtar siç janë përcaktuar në syllabus. Vlersimi përfundimtar i studentit bëhet me shumën totale të pikeve të fituara 0-100 pikë. Vlerësimi i vazhduar ka 40 pikë ndërsa provimi përfundimtar 60 pikë. Këto u konfirmuan dhe në takimet me stafin akademik dhe studentët. Neni 53 i Rregullores së Njesisë Kryesore dhe neni 33 i Njesisë Bazë përcakton sistemin e vlerësimit. GVJ konideron si të pa drejtë këtë metodë vlerësimi pasi për secilën notë të mundshme studentët kanë një hapësirë 10 pikë ndërsa për të marrë notën 10, studentët duhet të marrin 95 pikë

	<p>osë më lart. GVJ konsideron që kjo duhet të ndryshoj dhe të ndiqet e njëjta metodologji.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit; - Evidenca 2.5 Rregullore e FESHSS; - Evidenca 2.7 Rregullore DESHSRS; - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në javën orientuese studentët informohen për të gjithë syllabuset e semestrit. Studentët raportuan se në fillim të secilit modul ata informohen nga stafi akademik për modulën, vlerësimin, njohuritë që pritet të fitohen etj. Po ashtu raportuan se stafi akademik u vë në dispozicion syllabusin e lëndës. Neni 57, pika b e Rregullores së Institucionit përcakton se mënyrat e kontrollit të dijeve (sipas pikës përcaktohen në programin e Lëndës/modulit, në planin mësimor të studimeve dhe i behen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.6 Programet e lëndëve (syllabuset); - Evidencat 3.6.1-3.6.18; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.</p>	<p>Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një Lëndë/modul janë: testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit dhe provimi final. Detyrat e kontrollit janë elementë të vlerësimit të vazhduar të nivelit të dijeve. Detyrat e kontrollit organizohen javën e tetë të çdo semestri, mbi bazë grupi mësimor dhe vetëm gjatë orëve të planifikuara për seminare. Detyrat e kontrollit organizohen vetëm me shkrim. Provimi final organizohet a) me shkrim, b) me gojë, c) i kombinuar (me shkrim e me gojë). Departamenti përcakton nëse pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese apo eliminuese. Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e lëndës/modulit, si</p>




	<p>dhe vlerësimi përfundimtar. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit përfaqson 40% të vlerësimit total.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit; - Evidenca 2.5 Rregullore e FESHSS; - Evidenca 2.7 Rregullore DESHSRS; - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor"; - Evidenca 3.6 Programet e lëndëve (syllabuset); - Evidencat 3.6.1-3.6.18; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët. 			
Konkluzione	<p>Në nenet 55-57 të Rregullores së KUQ përcaktohen me detaje kriteret dhe mënyrat e vlerësimit/kontrollit të dijeve. Për vlerësimin e studentit përdoret sistemi pikëzimit me 100 pikë. GVJ konsideron si të pa drejtë këtë metodë vlerësimi pasi për secilën notë të mundshme studentët kanë një hapësirë 10 pikë ndërsa për të marrë notën 10, studentët duhet të marrin 95 pikë osë më lart. GVJ konsideron që kjo duhet të ndryshoj dhe të ndiqet e njëjta metodologji. Në javën orientuese studentët informohen për të gjithë syllabuset e semestrit. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një Lëndë/modul janë: testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit dhe provimi final.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e	Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e lëndës/modulit, si dhe vlerësimi përfundimtar. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit përfaqson 40% të vlerësimit total. Format e kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lëndë/moduli janë: testimi i ndërmjetëm, detyrat e kontrollit

<p>lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>dhe provimi final. Detyrat e kontrollit janë elementë i vlerësimit të vazhduar të nivelit të dijeve. Detyrat e kontrollit organizohen javën e tetë të çdo semestri, mbi bazë grupi mësimor dhe vetëm gjatë orëve të planifikuara për seminare. Detyrat e kontrollit organizohen vetëm me shkrim. Provimi final organizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Menyrat e kontrollit të dijeve përcaktohen në programin e çdo moduli dhe i bëhen të njohura studentit përgjatë javës së parë të mësimin. Provimi final organizohet dhe përfundon në datën dhe orarin e përcaktuar në grafikun e provimeve. Tezat e provimit hartohen nga titullari i lëndës/modulit dhe miratohet nga pergjegjësi i departamentit. Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet ndërrim teze. Provimet me shkrim zhvillohen në bazë kursi dhe të sekretuara. Kohezgjatja e një provimi me gojë është jo me shumë se 30 minuta për çdo student, ndërsa provimi me shkrim zgjat jo më shume se 3 orë.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit; - Evidenca 2.5 Rregullore e FESHSS; - Evidenca 2.7 Rregullore DESHSRS; - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”; - Evidenca 3.6 Programet e lëndëve (syllabuset); - Evidencat 3.6.1-3.6.18; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Nuk u raportuan sisteme elektronike të kontrollit dhe vlerësimit e testimit. Kjo është një pikë e dobët që Institucioni duhet të fokusohet.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Studentët vlerësohen në bazë të syllabusit dhe të legjislacionit në fuqi. Provimi final organizohet dhe përfundon në datën dhe orarin e përcaktuar në grafikun e provimeve. Grafiku i provimeve hartohet nga Departamenti dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Tezat e provimit hartohen nga titullari i lëndës/modulit dhe miratohet nga pergjegjësi i departamentit. Provimet organizohen mbi bazë kursi ose grupi mësimor. Komisionet e provimeve prozohen nga Drejtuesi i Departamentit dhe miratohet nga Dekani i</p>

	<p>Fakultetit. Nëse njëri nga pedagogët nuk mund të marrë pjesë në provim, ose kur drejtuesi i departamentit e gjykon, ai përcakton pedagogun që do ta zëvendësojë, sipas rregullave. Në rast pamundësie zëvendësimi, me propozim të Dekanit dhe miratim të Rektorit, provimi shtyhet jashtë sezonit brenda 5 ditëve nga perfundimi i tij.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor"; - Evidenca 3.6 Programet e lëndëve (syllabuset); - Evidencat 3.6.1-3.6.18; - Takim me stafin akademik.
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Stafi akademik zhvillon konsultime dhe informon studentët rregullisht duke bërë komente, kur e gjykon të arsyeshme. Gjatë vlerësimit të vazhduar stafi akademik orienton dhe jep komente në bazë të arritjeve akademike të studentëve. Pas përfundimit të provimit, në rast se studentët dëshirojnë mund të informohen nga stafi akademik mbi gabimet e tyre. Studentët, në bazë të komenteve të marra, mund të ankohen për vlerësimin ose të kërkojnë përmirësim të notës (neni 24 i Rregullores së programit të studimit). Pas shpalljes së rezultateve Sekretaria Mësimore në formë të skanuar rezultatet ua bënë të njohura studentëve të cilët kanë të drejtë të sqarohen për çdo paqartësi nga ana e komisionit të provimit. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit; - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor"; - Takim me stafin akademik.
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Provimet zhvillohen në orën dhe datën e caktuar. Komisioni i provimit të një lende/moduli përbëhet nga jo më pak se dy pedagogë, nën drejtimin e titullarit/pedagogut të lëndës. Përgjegjësia kryesore për mbarrëvajtjen e provimit, vlerësimin me notë të studentëve, duke marrë në konsideratë frekuentimin, vlerësimin e vazhduar, testimet e ndërmjetme, shlyerjen e detyrimeve, provimin përfundimtar dhe hedhjen e notave, është e pedagogut të lëndës, anëtar/kryetar i komisionit, që ka zhvilluar mësimdhënien me studentët. Pas dhënies së tezës, në provimin me shkrim, nuk lejohet futja në</p>

	<p>provim e studentëve të tjerë të grupit apo kursit përkatës. Anetaret e komisionit te provimit te lendes/modulit mbikeqyrin gjatë gjithë kohës për zhvillimin korrekt të provimit, nga dhënia e tezës deri në përfundimin e provimit. Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të stafit akademik te Kolegjit, me përjashtim të Drejtuesit të Departamentit, të Drejtuesit të Fakultetit apo persona të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani ose Rektori. Përdorimi i celularëve nuk lejohet në provim. Stafi akademik nuk lejon kopjimin në detyra/provime si dhe mundohen të mos lejojnë plagjaturën. Pavarësisht këtyre, KUQ nuk ka një sistem antiplagjiaturë.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit; - Evidenca 2.5 Rregullore e FESHSS; - Evidenca 2.7 Rregullore DESHSRS; - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”; - Takim me stafin akademik.
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Studentët raportuan se informohen për vlerësimin e vazhduar në klasë nga pedagogu i lëndës ndërsa për rezultatet e provimit në sekretarinë mësimore. Këtë e konfirmoj dhe sekretaria mësimore. Sipas Rregullores së Institucionit, rezultatet e provimit hidhen në sistem nga Komisioni i provimit brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe Brenda 10 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe gojë. Vonesa në dhënien e rezultatit të vlerësimit ngarkon me përgjegjësi administrative komisionin e provimit. Pas shpalljes së rezultateve dhe hedhjes së tyre në sistem, Sekretaria Mësimore në formë të skanuar rezultatet ua bënë të njohura studentëve të cilët kanë të drejtë të sqarohen për çdo paqartësi nga ana e komisionit, ose të kundërshtojnë rezultatin e marrë brenda 24 orëve. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara te studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të beje mbylljen e procesverbalit, dorëzimin në sekretari dhe hedhjen prej kësaj të fundit në sistem brenda dy ditëve. Në diskutimet e zhvilluara në</p>

	<p>KUQ, u raportua se sistemi nuk është ende funksional dhe se po punohet për ndërtimin e një të tilli.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit; - Evidenca 2.5 Rregullore e FESHSS; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët; - Takim me sekretarinë mësimore.
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet e provimit hidhen në sistem nga Komisioni i provimit brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe Brenda 10 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe gojë. Vonesa në dhënien e rezultatit të vlerësimit ngarkon me përgjegjësi administrative komisionin e provimit. Neni 65 i Rregullores së KUQ, neni 60 i Rregullores së Njesisë Kryesore, neni 35 i Rregullores së Njesisë Bazë dhe neni 23 i Rregullores së Programit të studimeve përcaktojnë procedurën e ankimimit të studentëve.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit; - Evidenca 2.5 Rregullore e FESHSS; - Evidenca 2.7 Rregullore DESHSRS; - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor".
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankohet te Dekani i Fakultetit në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Ankesa bëhet me shkrim përkatësisht pas zhvillimit të provimit për rastin e parë, dhe brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së njoftimit të rezultatit për rastin e dytë. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime drejtuesin e departamentit përkatës, komisionin e provimit, si dhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë ose jo dhe merr vendimin përkatës. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatit e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me drejtuesin e departamentit, që studenti të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit, ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkthës të provimeve. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në dekanat.</p>

	<p>Nuk u raportuan as nga studentët as nga stafi akademik raste ku ka patur ankimim të një note.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.4 Rregullore e Kolegjit; - Evidenca 2.5 Rregullore e FESHSS; - Evidenca 2.7 Rregullore DESHSRS; - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor” - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët. 			
Konkluzione	<p>Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e lëndës/modulit, si dhe vlerësimi përfundimtar. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit përfaqson 40% të vlerësimit total. Nuk u raportuan sisteme elektronike të kontrollit dhe vlerësimit e testimi. Kjo është një pikë e dobët që Institucioni duhet të fokusohet. Studentët vlerësohen në bazë të syllabusit dhe të legjislacionit në fuqi. Stafi akademik zhvillon konsultime dhe informon studentët rregullisht duke bërë komente, kur e gjykon të arsyeshme. Stafi akademik nuk lejon kopjimin në detyra/provime si dhe mundohen të mos lejojnë plagjaturën. Rezultatet e provimit hidhen në sistem nga Komisioni i provimit brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda 10 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe gojë. Studenti ka të drejtë të ankohet për një notë që e konsideron të pa drejtë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë	Në bazë të planit mësimor, programi i studimit me karakter profesional 2 vjeçar “Kujdes Social dhe Shëndetësor” ka si qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive të studentëve me qëllim përgatitjen e tyre sa më adëkuate për tregun e punës. Studnetët përmes praktikave të cilat zhvillojnë përfitojnë

<p>profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>aftësi të veçanta për ti implementuar ato gjatë ushtrimit të profesionit. Objektivi kryesor i këtij programi studimi është formimin e teknikëve të lartë në fushën e kujdesit social dhe shëndetësor. Programet e lëndëve të këtij programi studimi synojnë thellimin zgjerimin dhe specializimin e njohurive teorike dhe aftësive për shërbime shëndetësore dhe sociale. Në fokusin e tij të plotë, ky program studimi gërsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar tek studenti mendimin kritik dhe krijues, si edhe për t'i ekspozuar ata drejt çështjeve me rëndësi në fushën sociale dhe shëndetësore nëpërmjet një modeli mësimi të mbështetur fuqishëm nga praktika profesionale në këto fusha.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”; - Evidenca 3.3 Plani Mësimor; - Evidenca 3.11 Dosja e programit me karakter profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Bazë.
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Programi i studimit përfshin marrjen e aftësive dhe njohirve në fushën sociale, aftësive komunikuese dhe të ndërveprimit. Plani mësimor përmban lëndë si Sociologji, Psikologji Shëndeti, E drejta Sociale dhe e Punës dhe Zhvillimi i Aftësive Komunikuese.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”; - Evidenca 3.3 Plani Mësimor.
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.</p>	<p>Stafi akademik zhvillon rregullisht konsultime me studentët si dhe u vë atyre në pah pikat më të rëndësishme të lëndëve respective. Stafi akademik zhvillon orë orientuese në bazë të nevojave të studentëve. Ata raportuan se konsultime/orë orientuese zhvillohen sado herë studentët raportojnë nevojën. Studentët konfirmuan zhvillimin e orëve të tilla. Për detyrimet përmblylëse studentët nuk janë informuar akoma pasi këtë vit do të diplomohet brezi i parë. Informacioni do tu jepet studentëve periudhën në vijim, raportoi Drejtuesia e Njesisë Bazë.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takim me Drejtuesen e Njesisë Bazë; - Takim me stafin akademik;

	- <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<p>Përveç orëve të leksioneve, studentët në programin e studimit "Kujdes Social dhe Shëndetësor" zhvillojnë seminare, laboratore, praktika profesionale etj me qëllim përfitimin e kompetencave të cilat do ti praktikojnë gjatë ushtrimit të profesionit. Personeli akademik raportoi se mbështet diskutimet në klasë si dhe u jep mundësinë studentëve të mendimit kritik. Pavarësisht se KUQ ka marrveshjeve, asnjë nga studentët që morrën pjesë në takim nuk kishte zhvilluar mobilitet.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor";</i> - <i>Evidenca 3.3 Plani Mësimor;</i> - <i>Takim me stafin akademik;</i> - <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>Orë të hapura dhe seminare të ndryshme zhvillohen rregullisht në KUQ. Drejtuesia e Njesisë Bazë raportoi se leksioni i fundit i hapur u zhvillua nga Mimoza Kala. Këto aktivitete kanë si qëllim informimin e stafit akademik dhe studentëve mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Evidenca 2.12 Raport, plan pune dhe aktivitetet vjetore per vitin akademik 2022-2023, ZMJP&KK;</i> - <i>Takim me Drejtuesen e Njesisë Bazë.</i>
Konkluzione	<p><i>Në bazë të planit mësimor, programi i studimit me karakter profesional 2 vjeçar "Kujdes Social dhe Shëndetësor" ka si qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive të studentëve me qëllim përgatitjen e tyre sa më adëkuate për tregun e punës. Programi i studimit përfshin marrjen e aftësive dhe njohirve në fushën sociale, aftësive komunikuese dhe të ndërveprimit. Staf i akademik zhvillon rregullisht konsultime me studentët si dhe u vë atyre në pah pikat më të rëndësishme të lëndëve respective. Përveç orëve të leksioneve, studentët në programin e studimit "Kujdes Social dhe Shëndetësor" zhvillojnë seminare, laboratore, praktika profesionale etj. me qëllim përfitimin e kompetencave të cilat do ti praktikojnë gjatë ushtrimit të profesionit. Orë të hapura dhe seminare të ndryshme zhvillohen rregullisht në KUQ.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.</p>	<p>Në këtë program studimi 2-vjeçar «Kujdes Social dhe Shëndetësor», studentët diplomohen me provim përfundimtar të provimit. Neni 27 i Rregullores së Programit të studimit përcakton modalitetet për detyrimet përmbyllëse. Brenda dy muajve nga dita e fillimit të vitit akademik, departamentet u bejnë të njohur studentëve të vitit të fundit programet e provimit të formimit, provimit të përgjithshëm përfundimtar. Sekretaria Mesimore informon studentët rreth organizimit të provimeve të formimit. GVJ vëren se procedura e diplomimit për programet me karakter profesional nuk parashikohet në Rregulloren e Njesisë Bazë dhe sugjeron që kjo të ndryshoj.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”; - Evidenca 3.3 Plani Mësimor.
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Brenda dy muajve nga dita e fillimit të vitit akademik, departamentet u bejnë të njohur studentëve të vitit të fundit programet e provimit të formimit, provimit të përgjithshëm përfundimtar. Sekretaria Mesimore informon studentët rreth organizimit të provimeve të formimit. Drejtuesia e Njesisë Bazë raportoi se ata po përgatisin temat të cilat do tu jepën studentëve. Këtë e konfirmuan dhe studentët në takimin e zhvilluar.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”; - Evidencë 3.10 Programi për provimin e formimit, 2023-2024; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Bazë; - Takim me studentët.

<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Diplomimi me provim formimit bëhet në sezonin e verës (qershor/korrik), për studentët e prapambetur, në sezonin e pranverës (mars) dhe sipas vendimeve të Senatit të Kolegjit Universitar për "Qiriazi". Datat e provimeve të formimit përcaktohen nga Dekani i Njesisë Kryesore dhe shpallen një muaj para. Provimi përfundimtar përfshin njohuritë e marra në të dy vitet e studimeve. Temat propozohen nga stafi akademik respektiv i Departamentit dhe më pas përcillen tek Dekani për miratim. Komisioni përbëhet nga 3-5 anëtarë, propozohet nga Departamenti dhe miratohet nga Dekani (neni 52 i Rregullores së Departamentit).</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.7 Rregullore DESHSRS; - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor"; - Evidencë 3.10 Programi për provimin e formimit, 2023-2024; - Takim me Drejtuesen e Njesisë Bazë.
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Nuk parashikohet për këtë program studimi diplomimi me tem diplome.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave</p>	<p>Studentët kanë mundësinë të përdorin ambientet e Institucionit për zhvillimin e procesit mësimor si dhe të praktikave mësimore. Studentët kanë mundësinë të përdorin laboratorin e informatikës, bibliotekën, laboratorët e programit si dhe infrastrukturën sportive të KUQ. Këto u konfirmuan në takimin me stafin akademik dhe studentët.</p> <p>Evidenca:</p>

të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.	<ul style="list-style-type: none"> - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët; - Vëzhgimi i ambienteve gjatë vizitës në KUQ.
Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.	<p>Në përfundim të detyrimeve përmbyllëse, studentët vlerësohen me notë. Nota llogaritet si mesatarja e të gjithë anëtarëve të komisionit. Ata informojnë studentin për notën e fituar (neni 52, pika 5). GVJ konsideron që informacioni për procedurën e diplomimit të programeve me karakter profesional të përfshihen në Rregulloren e Njësisë Bazë (nenet 51-52) si dhe në Rregulloren e Institucionit (neni 83-84).</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.7 Rregullore DESHSRS; - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor".
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me "Çertifikatë profesionale" ose "Diplomë profesionale" në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<p>Studenti që kalon me sukses provimin përfundimtar të diplomimit, pajiset me diplomën përkatëse. Në dokumentin e diplomës shënohet fusha e studimit të përfunduar dhe specialiteti përkatës. Diploma firmoset nga Sekretaria mësimore, Dekani i FESHSS dhe Rektori i Kolegjit Universitar "Qiriazi". Diploma shoqërohet me listën e notave.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 2.7 Rregullore DESHSRS; - Evidenca 3.1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor".
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	<p>Kopje e dokumentacionit të studentit ruhet në bazë të legjislacionit në fuqi. Kopje e këtij dokumentacioni ju paraqit dhe GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore. Ruajtja e dokumentacionit të studentit është në detyrat kryesore të sekretarisë mësimore. Gjatë vizitës në sekretari, u raportua se QSHA ende nuk ka përcjell regjistra dhe për këtë arsye nuk kishte regjistër themeltar si dhe të arritjeve akademike.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.12 Rregullore e sekretarisë mësimore; - Vizita në sekretarinë mësimore.
Konkluzione	<i>Në këtë program studimi 2-vjeçar «Kujdes Social dhe Shëndetësor», studentët diplomohen me provim përfundimtar</i>

	<p>të provimit. GVJ vëren se procedura e diplomimit nuk parashikohet në Rregulloren e Njësisë Bazë dhe sugjeron që kjo të ndryshoj. Provimi përfundimtar përfshin njohuritë e marra në të dy vitet e studimeve. Temat propozohen nga stafi akademik respektiv i Departamentit dhe më pas përcillen tek Dekani për miratim. Studentët kanë mundësinë të përdorin ambientet e Institucionit. Në përfundim të detyrimeve përmbyllëse, studentët vlerësohen me notë. Studenti që kalon me sukses provimin përfundimtar të diplomimit, pajiset me diplomën përkatëse. Kopje e dokumentacionit të studentit ruhet në bazë të legjislacionit në fuqi.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Institucioni inkurajon përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative gjatë mësimdhënies. Në periudhën e pandemisë KUQ ka hartuar një udhëzues për metodat e mësimdhënies dhe didaktikës në distancë. Paralelisht, inkurajon stafin për përdorimin e platformave on-line për mësimdhënien (GoogleClasroom). Përdorimi i kësaj platforme u konfirmua nga stafi akademik dhe studentët. Stafi akademik raportoi se nuk ka në dispozicion ndonjë udhëzues për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. GVJ-së nuk ju vu në dispozicion një dokument i tillë. GVJ konsideron si të rëndësishëm hartimin e një udhëzuesi të tillë.</p> <p>Evidenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.18 Metodave të mësimdhënies në distancë; - Evidenca 1.19 Udhëzues për përdorimin e platformave on-line; - Takim me stafin akademik.
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë</p>	<p>Institucioni zhvillon rregullisht vlerësimin e stafit akademik nga studentët përmes një pyetësoi (në fund të semestrit / 2</p>

<p>mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>herë në vit). Rezultatet i përcillen Rektorit dhe më pas Dekanit dhe Drejtuesit të Departamentit. Një praktik e mirë që KUQ implementon është dhe vlerësimi i stafit akademik nga eprori. Formulari i përgatitur sugjerohet të shtohen dhe disa pika mbi mësimdhënien. GVJ sugjeron që Instituoni të krijoj mekanizma të ndryshëm (perveç të sipër përmendurave) për vlerësimin e rregullt të mësimdhënies.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.5. Rregullore e NJSBC; - Evidenca 1.5. 1 Politikat e NJSBC; - Evidenca 1.5.2 Raporti Vjetor i NJSBC; - Evidenca 1.7 Politikat e vlerësimit të brendshëm; - Evidenca 2.26.1 Model template, Pyetëtori i studentit; - Evidenca 2.26.4 Model template, Formular vlerësimi i performancës së personelit akademik; - Takim me përfaqësues të Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
<p>Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBC çdo vit përgatit një raport vjetor. Raporti vjeotr përfshin dhe rezultatet e pyetësorit të studentëve. Studentët raportuan se informohen mbi këto rezultate.</p> <p>Evidenca</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evidenca 1.5.2 Raporti Vjetor i NJSBC.
<p>Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni organizon rregullisht seminare e trajnime për mësimdhënien të stafit akademik. Vlerësimi i mësimdhënies përmes pyetësorit të studentëve zhvillohet dhe është një praktik e mirë. Përmes përdorimit të fondit të kërkimit shkencor, KUQ inkurajon stafin akademik për të marrë pjesë në konferenca shkencore ose të zhvilloj botime. Shembuj specifik të promovimit të praktikave të mira për përmirësim të mëtejshëm të mësimdhënies, nuk u raportuan.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni inkurajon përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative gjatë mësimdhënies. GVJ konsideron si të rëndësishëm hartimin e një udhëzuesi për metodat innovative të mësimdhënies. Një praktik e mirë që KUQ implementon është dhe vlerësimi i stafit akademik nga eprori. NJSBC çdo vit përgatit një raport vjetor. Raporti vjeotr përfshin dhe rezultatet e pyetësorit të studentëve. Shembuj specifik të promovimit të praktikave të mira për përmirësim të mëtejshëm të mësimdhënies, nuk u raportuan.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik dhe ndihmës akademik që angazhohet në realizimin e Programit të Studimit me Karakter Profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor” është në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p>Në aspektin e kualifikimit akademik, në të gjitha syllabuset e lëndëve/moduleve përbërëse të programit të studimit titullarët e tyre janë kategoria “Profesor”, janë të profilizuar në fushën përkatëse si dhe kanë eksperiencën profesionale dhe akademike specifike në lidhje me lëndën përkatëse. Institucioni ka të përcaktuara në rregulloren institucionale procedurat e punësimit, ku përfshihen edhe kriteret e punësimit të stafit akademik në përputhje me fushën përkatëse. Gjithashtu institucioni ka hartuar një strategji në lidhje me planin strategjik të kualifikimit të stafit e cila tenton ti aftësojë specifikisht për fushat dhe lëndët që ata mbulojnë. Në evidencat e paraqitura bashkë me RVB, janë prezente, shumica e cv-ve por mungojnë disa.</p> <p>Referuar (<i>Evidencë_2_27_1_Informacion tabelor mbi Planin mësimor lidhur me personelin akademik përkatës për programin profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”</i>) për</p>

vitin akademik 2023 – 2024 në këtë program studimi janë angazhuar në mësimdhënie staf akademik si më poshtë vijon:

Stafi akademik për programin e studimit “Kujdes Social dhe Shëndetësor”	2023-2024	
	PAE	PAK
Prof. Dr	2	-
Prof.Ass	2	-
Dr/PhD	3	3
Msc	4	1
Totali	11	4

Ne evidencën nr.prot 136 dt 20.09.2023 në lidhje me stafn akademik që realizon ngarkesën mësimore mungon lënda Praktikë Profesionale por është e specifikuar në planin mësimor dhe syllabusin e lëndës si dhe në listën emërore të stafit akademik me ngarkesat përkatëse. **Rekomandohet që të shohet stafi akademik me grada e tituj për të mbështetur procesin mësimor si dhe për të rritur raportin e kësaj kategorie.**

KUQ ka politika mbështetëse në lidhje me trajnimin e vazhdueshëm të stafit akademik.

Ev. Stafi i programit DP. Kujdes Social dhe Shendetesor.

Ev. 2_27_1, 2

Ev. 3_4,5

Ev. 3_6,-11 Syllabuse

Ev. 1_13_5_ Plani Strategjik mbi trajnimin.

Ev. 1_17_Udhëzues për kualifikimin e stafit.

Evidencë 2_25_ Të mbi aktivitetin, kërkimin shkencor dhe kualifikimin 2020-2023..

Evidencë 2_37_ Lista e trajnimeve.

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

PAE (personeli akademik efektiv) që mbulon ngarkesën mësimore të programit të studimit, bazuar në Evidencat e paraqitura nga institucioni, rezulton të jetë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. PAE mbulon mbi 70% të ngarkesës mësimore konkretisht 990 orë (80 %) nga 1230 orë në total. Gjithashtu raporti PAE/PAK është rreth 74.6% /26.4 % i cili është në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Ngarkesa mësimore e stafit efektiv dhe joefektiv, bazuar në evidenca dhe të dhënat nga vizitat, shpërmdahet në përputhje me aktet

	<p>ligjore në fuqi, <i>Udhëzim Nr. 29, Datë 10.09.2018 Për Veprimtarinë Dhe Ngarkesën Mësimore Të Personelit Akademik Në Institucionet E Arsimit Të Lartë</i>. PAE ka ngarkesa mesimore midis 45– 190 ore mesimore dhe PAK jo më shumë se 120 orë mesimore në një vit akademik.</p> <p><i>Ev_3_5 Personeli Akademik, ndihmëakademik dhe administrativ.</i></p> <p><i>Ev. Stafit i programit DP. Kujdes Social dhe Shëndetësor</i></p> <p><i>Ev_2_27_Informacion tabelor mbi Ngarkesa totale e personelit akademik të programit profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të 48tuden periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit e të dhënave në Evidencat e paraqitura nga institucioni, rezultoi se stafi akademik është i qëndrueshëm, dhe prej disa vitesh. Duhet patur parasysh se ky program është dyvjeçar dhe disa prej stafit akademik që mbulon lëndë specifike dhe karakterizuese të programit të studimit janë punësuar që në fillimin e këtij programi studimi. Institucioni për çdo punonjes mban dosjen personale, ku përfshihen të dhënat individuale, kontrata e punës, diplomat, lista e notave si dhe kualifikimet përkatëse. Gjithashtu nga deklaratimet financiare të realizuara nga institucioni rezultoi se në përputhje me kontratën e punës punonjësit janë të siguruar me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Institucioni shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore i ka zë të vecantë edhe e buxhetin e miratuar si dhe të specifikuar në modelin e kontratës të punës që u vu në dispozicion gjatë vizitës. Gjithsesi GVJ nuk ka evidencë për shlyerjen e këtij detyrimi.</p> <p>KUQ ka disa politika me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së stafit akademik sic janë politikat e financimit të kërkimit shkencor.</p> <p><i>Ev_1_22_Plani buxhetor</i></p> <p><i>Ev_1_26_Vendim i B A për pagesën e konferencave dhe bibliotekës.</i></p> <p><i>Ev_1_27_Miratim i fondit, për punën shkencore</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedurën e rekrutimit dhe vlerësimit, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që</p>	<p>Institucioni ka hartuar dhe miratuar rregulloren e Zyrës së Burimeve Njërzore dhe Protokoll-Arkivit e cila bazuar në Satutin dhe rregulloren institucionale ka të specifikuar procedurën e rekrutimit. Njësitë bazë dhe kryesore paraqesin vëndet vakante në bazë të planit mësimor hartojnë kriteret</p>

<p>garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>specifike në përputhje me to. Kriteret miratohen nga titullari i institucionit. Shqyrtimi dhe përzgjedhja e fituesve bëhet nga një komision i posaçëm ku bëjnë pjesë Rektori, përfaqësues nga njësitë që kanë propozuar vendet vakante, Burimet njerzore dhe administratori.</p> <p>Në këtë pikë GVJ, bazuar në ligjin e arsimit të lartë LAL 80/2015 rekomandon që komisioni për rekrutimin e stafit akademik mos të ketë në përbërje administratorin pasi ky autoritet drejtues nuk vlerëson stafin akademik dhe përshtatjen e tij me modulet por procedurat administrative të institucionit. Konkursi zhvillohet me konkurim të hapur, transparent dhe objektiv. Në evidencat e paraqitura nuk rezultoi të kishte një procedurë konkrete të punësimit.</p> <p><i>Ev. 1_13_Rregullore e ZBNJ dhe procedura</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Programi i Studimit me Karakter Profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor” është një program i ri, në të cilin ka të regjistruar në total 21 studentë, dhe ende nuk ka rekrutuar personel ndihmës akademik për procesin mësimor dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës laboratorike apo mjediseve mësimore specifike të këtij programi. Aktualisht këtë detyrë e mbulojnë titullarët e lëndës dhe stafi administrative i KUQ. GVJ rekomandon që institucioni për të rritur dhe zhvilluar programin e studimit dhe për të ofruar një cilësi më të lartë në procesin mësimor të angazhohet në rekrutimin e stafin ndihmës akademik te këtij program studimi.</p> <p><i>Evidencë_3_5 Personeli Akademik, ndihmëakademik dhe administrativ.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo 49tudente dhe vit akademik, si dhe atë të</p>	<p>KUQ ka të përcaktuar në rregulloren e Kolegjit dhe rregulloren e ZBNJ një strukturë të vecantë sic është Zyra e Burimeve Njerzore dhe Protokoll-Arkivit për mbledhjen, ruajtjen e informacionit mbi stafin akademik të anagazhuar për cdo vit akademik sipas nje liste dokumentacioni bazë. Të dhënat përmbajnë listat emërore të stafit akademik sipas programeve të studimit, koordinorit e programit si dhe të dhëna të tjera ns lidhje me stafin ndihmës. Një kopje e dosjeve personale u deklarua gjatë vizitës që ruhen edhe në department.</p> <p><i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit.</i></p> <p><i>Ev. 1_13_Rregullore e ZBNJ dhe procedura</i></p>

<p>personelit ndihmësakademik dhe 50studentet50tive.</p>	<p><i>Ev. 1_11_Rregullore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.</i></p> <p><i>Evidencë 2_28_1 Lista e dokumentave në dosjen e personelit.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në Evidencat e paraqitura nga KUQ, institucioni ka disa marrëveshje dhe bashkëpunime me institucione të tjera në funksion të realizimit të praktikës profesionale dhe veprimtarive të tjera specifike të programit të studimit.</p> <p>Institucioni ka edhe një zyrë për mardhëniet dhe bashkëpunimet për brenda dhe jashtë vendit si dhe një rregullore specifike përkatëse. Institucioni deklaron që ka lidhur marrëveshje me disa qendra të kujdesit shëndetësor, kujdesit për të moshuarit dhe Kryqin e kuq. Mungojnë marrëveshjet konkrete. Në Evidencat e paraqitura ka disa marrëveshje dhe mobilitete ERASMUS+ por jo specifike për programin e studimit.</p> <p><i>Nuk ka të dhëna për mobilitete të studentëve të këtij program studimit. GVJ rekomandon të rriten bashkëpunimet dhe mobilitetet specifike të programit të studimit me qellim ndërkombëtarizimin e tij.</i></p> <p><i>Ev. 1_14_Rregullore e ZMJP&KK</i></p> <p><i>Ev. 1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit.</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë 50studentet në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Praktika profesionale rregullohet me anë të rregullores specifike. Në syllabus përshkruhen qartë objektivat dhe rezultatet e të nxenit si dhe skema e vlerësimit të saj. Praktikanti vlerësohet sipas nje Sistemi pikëzimi lidhur me dosjen e praktikës shoqëruar me vlerësimin e ëudhëheqësit të praktikës profesionale, struktura e saj dhe individualitetit. Në përputhje me marrëveshjet specifike, cikli i pare i studentëve ka miratuar kryerjen e praktikës profesionale pranë disa institucioneve me mbeshtetjen e personelit akademik efektiv dhe personelit në institucionin pritës.</p> <p><i>Evidencë 3_6_18 Praktikë profesionale 2.</i></p> <p><i>Evidencë 3_7_Udhëzues i Praktikave.</i></p> <p><i>Evidencë 3_8_Dosja e praktikave viti akademik 2023-2024</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Personeli akademik që angazhohet në realizimin e Programit të Studimit me Karakter Profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor” është në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi. PAE mbulon mbi 70% të ngarkesës mësimore, dhe ka raportin PAE/PAK është rreth 74.6% /26.4 %.. KUQ</i></p>

	<p>duhet te rrisë numrin e stafit akademik me grada dhe tituj. KUQ rekruton stafin në përputhje me rregulloren specifike të Zyrës së Burimeve Njërzore dhe Protokoll-Arkivit, por komisioni I rekrutimit nuk duhet të ketë në përbërje administratorin pasi ky autoritet drejtues nuk vlerëson stafin akademik sipas LAL 80/2015. Institucioni për çdo punonjës mban dosjen personale me dokumentacionin përkatës bashkë me kontratat punës. Programi i Studimit me Karakter Profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor” ende nuk ka rekrutuar personel ndihmës akademik për procesin mësimor dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës laboratorike apo mjediseve mësimore specifike të këtij programi. Institucioni ende ka një numër të pakët marrëveshesh dhe bashkëpunimesh me institucione të tjera në funksion të realizimit të praktikës profesionale dhe veprimtarive të tjera specifike të programit të studimit. Praktika profesionale rregullohet me anë të rregullores specifike. Praktika profesionale rregullohet me anë të rregullores specifike dhe ky është viti I parë I zhvillimit të saj .</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi RVB, evidencat dhe pas vizitës në institucion, konstaton se KUQ ka infrastrukturë në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Ka certifikatë të mbrojtjes nga zjarri, lejën higjieno-sanitare si dhe aktet e tjera për sigurinë teknike dhe shëndetësore. Mqse është program i ri studimi, dhe ka numër të vogël studentesh (21 total) raporti student/m² është optimal me vlerë rreth 2.5 në nivel fakulteti. Gjithashtu institucioni siguron mjedise të përshtatshme edhe për stafin administrativ me një raport 9.6 m² për person.</p> <p><i>Evidencë 2_33_ Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.</i></p>

	<p><i>Evidencë 2_34_ Projekt buxheti për VA 2022-2023. Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Në dispozicion të programit të studimit ka edhe një laborator me disa mjete didaktike për realizimin e lëndëve specifike. Konkretisht laboratori përmban mjete mësimore si krevat për menaxhimin e pacientëve, karrige me rrota, peshore për fëmije, aparat tensioni etj. Gjithsesi ende laboratori, nuk i ka të gjitha mjetet që garantojnë procesin mësimor teorik dhe praktik. Rekomandojmë që ky laborator të pasurohet më tej me pajisje dhe aparatura të cilat janë në funksion të programit të studimit. Klasat dhe auditorët janë të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies, si videoprojektore dhe tabela ëhiteboard, internet por duhet akoma punë dhe kohë për të integruar më shumë teknologjië e mësimdhënies së dixhitalizuar në proceset mësimore. Aktualisht përdoret platforma moodle për disa nga aktivitetet te procesit mesimor dhe didaktik</p> <p><i>Ev. 1_24_Infrastruktura mësimore KUQ.</i></p> <p><i>Ev. 1_24_Infrastruktura mësimore pjesa II.</i></p> <p><i>Ev. 1_36_Faqja zyrtare e internetit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në funksion të programit të studimit, KUQ ka krijuar një ambjent të përshtatshëm për zhvillimin e orëve të praktikës lëndore “Salla e kujdesit social dhe shëndetësor” e cila është optimale për 15 -16 studentë por nqse do te kete numër me te lartë do të jetë e nevojshme të shtohen mjetet dhe laboratorë të tjerë në funksion të lëndëve me karakter klinik si infermieristikës, psikoterapise, rehabilitim, anatomi dhe geriatri. Në këte menyrë do të jenë me funksionale dhe eficente në arritjen e objektivave të lëndëve dhe rezultateëve te te nxenit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas</p>	<p>Institucioni ka dy laborator të teknologjisë së informacionit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Laborator i Shkencave te Aplikuara dhe Reabilitimit me 16 vende te pajisur me kompjutera dhe programe profesionale specifike; 2. Laboratori i Teknologjisë së informacionit; <p>Keto laboratore aktualisht për numërin e studenteve në këtë program studimi janë të mjaftueshëm. Duhet të shihet</p>




natyrës së programit të studimit që ofron.	mundësia me rritjen e numërit të studentëve edhe krijimi i platformave elektronike që shërbejnë për informacionin e studentëve si notat, vlerësimin në kologjume apo komunikime të tjera. Gjithashtu do të ishte pozitive edhe përdorimi i disa platformave publike për komunikimin e studentin sic është googleclassroomë, teams etj. <i>Ev. _1_24_Infrastruktura mësimore KUQ.</i>			
Konkluzione	<i>KUQ ka infrastrukturë në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Ka certifikatë të mbrojtjes nga zjarri, lejën higjeno-sanitare si dhe aktet e tjera për sigurinë teknike dhe shëndetësore. Në dispozicion të programit të studimit ka edhe një laborator me disa mjete didaktike për realizimin e lëndëve specifike por ende duhet të plotësohet me mjete të tjera. KUQ ka krijuar një ambient të përshtatshëm për numrin e studentëve aktualë për zhvillimin e orëve të praktikës lëndore "Salla e kujdesit social dhe shëndetësor", Do ishte pozitive krijimi i platformave elektronike që shërbejnë për informacionin e studentëve .</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Programi i studimit, në përputhje me planin mësimor ka të specifikuar në mënyrë të detajuar në syllabuset lëndore literaturë bazë dhe të këshilluar. Shumica e literaturave, janë të disponueshme edhe fizikisht edhe dixhitalisht. Literatura e miratuar në syllabuse është e bollshme dhe garanton njohuritë e nevojshme të parashikuara në programin e studimit që lidhen me rezultatet e të nxënit. Literatura bazuar në rregulloren institucionale por edhe atë të programit të studimit është e detyrueshme të rishikohet çdo rifillim viti akademik gjë që sjell shfrytëzimin të literaturës bashkëkohore.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke	Biblioteka është e aksesueshme nga të gjithë studentët. Aksesimi, pasurimi, ruajtja e literaturës bazë dhe ndihmëse, anëtarësimi dhe administrimi rregullohen me anë të

<p>garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>rregullores specifike të bibliotekës. Referuar statutit, rregullores institucionale dhe rregullores së bibliotekës institucioni garanton aksesin me të drejta të barabarta edhe midis studentëve të këtij program studimi por edhe në raport me studentët e tjerë.</p> <p><i>Ev. 1_9_Rregullore e brendshme e bibliotekës.</i></p>
<p>Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>KUQ ka pjesë të infrastrukturës bibliotekën institucionale ku janë të pranishme literaturë bazë dhe një gamë e gjerë literature ndihmëse në gjuhën shqipe, gjuhë në të cilën ofrohet programi i studimit. Literatura disponohet edhe në formë dixhitale. Biblioteka funksionon dhe pasurohet në përputhje me rregulloren specifike të saj.</p> <p><i>Ev. 1_9_Rregullore e brendshme e bibliotekës.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nuk ka të dhënë që institucioni ka apo është i abonuar në biblioteka online ku aksesin i literaturës është akoma edhe më i madh. Rekomandohet që institucioni të rrisë aksesin në biblioteka online apo platforma të ngjashme në përputhje me fushën e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p>	<p>KUQ ka në strukturën e saj 2 ambiente me funksionin e bibliotekës me sipërfaqe totale 45m². Institucioni ka hartuar edhe rregulloren specifike për organizimin, funksionimin dhe ruajtjen e librave, revistave dhe materialeve të tjera. Biblioteka është e pajisur me disa kompjutera për poste për përdoruesit, ka akses me internet dhe printera në përdorim. Rekomandohet që të mundësohet abonimi në biblioteka online ose forma të tjera të cilat mundësojnë aksesin e librave, artikujve apo literaturës bazë dhe të këshilluar.</p> <p><i>Ev. 1_9_Rregullore e brendshme e bibliotekës shilluar të programeve të studimit që ofron.</i></p> <p><i>Ev. 1_24_Infrastruktura mësimore KUQ</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi</p>	<p>Biblioteka është e vendosur në pozicion të arritshëm nga të gjithë studentet, ajo funksionon në orarin 8.00 – 17.00 (e hënë - të premte) Në këtë orar, zhvillohet edhe mësimi për</p>

<p>që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>programin e studimit gjë që lehtëson aksesin e saj nga studentët. Numri i posteve në bibliotekë është 15, i cili është i përshtatshëm për numërin e studentëve të programit të studimit (21 në total), por referuar numërit të studenteve total në institucion këto poste rekomandojme të shtohen, në mënyre që të kenë hapsirën dhe kohën e duhur për ta aksesuar të gjithë.</p>			
<p>Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.</p>	<p>Institucioni ka të përcaktuar në Planin strategjik të zhvillimit të vet, edhe zhvillimin e bibliotekës dhe pasurimin e saj. Në këtë kuadër, njësitë bazë dhe njësitë kryesore në fillim të vitit akademik hartojnë listën e literaturës së nevojshme për programin e studimit, e cila mbështet edhe nga Evidencat përkatëse. Në RVB konfirmohet pasurimi i bibliotekës edhe nga vetë stafi akademik si bashkëautorë të literaturave lidhur me programin e studimit.</p> <p>Referuar programit të ri të studimit, rekomandojme shtimin e fondit fizik dhe online në bibliotekën e institucionit.</p> <p><i>Evidencë 2_14_ Plani Strategjik.</i></p> <p><i>Evidencë 2_20_ Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë në funksion të programit.</i></p> <p><i>Ev. 1_26_ Vendim i B A për pagesën e konferencave dhe bibliotekës.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit, në përputhje me planin mësimor ka të specifikuar në mënyrë të detajuar në syllabuset lëndore literaturë bazë dhe të këshilluar. Shumica e literaturave, janë të disponueshme edhe fizikisht edhe dixhitalisht. Literatura e miratuar në syllabuse është e bollshme dhe e disponueshme në bibliotekë. Aksesin, pasurimin, ruajtjen e literaturës bazë dhe ndihmëse, anëtarësimi dhe administrimi rregullohen me anë të rregullores specifike të bibliotekës. Me shtimin e numrit të studenteve duhet të shtohen dhe postet e saj. Nuk ka të dhënë që institucioni ka apo është i abonuar në bibliotekë online ku aksesin e literaturës është akoma edhe më i madh. Institucioni ka të përcaktuar në Planin strategjik të zhvillimit të vet, edhe zhvillimin e bibliotekës dhe pasurimin e saj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.	<p>Institucioni, bazuar në Evidencat e paraqitura disponon një sistem menaxhimi me të cilin administrojnë, menaxhojnë dhe ruajnë informacionin dhe të dhënat administrative, financiare dhe akademike. Sekretaria përdor sistemin SMI si formë elektronike për administrimin dhe ruajtjen e të dhënave, por edhe regjistrat hard copy. Gjatë vizites GVJ konstatoi se regjistrat themeltarë edhe pse janë kryer procedurat e tërheqjes së tyre në përputhje me udhëzimet e MAS, ende nuk janë vënë në dispozicion nga QSHA, me të cilën ka një seri komunikime zyrtare në lidhje me çështjen.</p> <p>Institucioni gjithashtu përdor edhe platformat online të miratuara për aplikimin dhe regjistrimin e maturanëve si U-albania si dhe platformën e Ascal për proceset e vlerësimit të cilësisë dhe ruajtjes së informacionit përkatës në përputhje me ligjin e Arsimit të lartë LAL 80/2015. KUQ ka hartuar një rregullore specifike në lidhje me ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit duke mundësuar edhe memorjen institucionale në vazhdimësi.</p> <p><i>Ev. 1_11_Rregullore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.</i></p> <p><i>Ev. 1_12_Rregullore e sekretarisë mësimore.</i></p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Sistemi i brendshëm informatik shërben jo vetëm për administrimin dhe ruajtjen e të dhënave për studentët dhe procesin akademik por edhe për aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ si dhe bashkëpunimet me të tretë. Institucioni zbaton politikat e ruajtjes së të dhënave personale, dhe ka hartuar dhe miratuar një rregullore specifike për këtë aspekt.</p> <p><i>Ev. 1_10_Rregullore e mbrojtjes së të dhënave personale.</i></p>

<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Ne RVB raportohet që institucioni është në proces implementimi të sistemit të dedikuar LMS në lidhje me aksesin e dedikuar të personelit dhe studentëve. Rekomandohet përdorimi i platformave të suksessheme në institucione të tjera të arsimit të lartë në këtë drejtim.</p> <p>Për disa nga platformat online që përdoren për proceset akademike institucioni ka hartuar udhëzues të posaçëm. Institucioni ka hartuar dhe miratuar edhe një udhëzues specifik për metodat e mësimdhënies në distancë e cila e rrit mundësinë e komunikimit pedagog – student- administrate.</p> <p><i>Ev. 1_18_ Metodat e mësimdhënies në distancë.</i></p> <p><i>Ev. 1_19_ Udhëzues për përdorimin e platformave on-line</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Komunikimi interaktiv është një process dinamik dhe institucioni ka bërë përpjekje për ta përmirësuar duke implementuar mekanizma të ndryshëm si platformat online, google classroom, emailin zyrtar, faqen zyrtare të tij website, këndin e lajmërimeve si dhe format aktuale median sociale. Në këtë drejtim zhvillimi teknologjik është sfidues dhe nxit metoda inovatore dhe efikase për një komunikim sa më të shpejtë dhe saktë. Futja e platfomes Moodle është një tregues i përmirësimit të procesve të komunikimit midis grupeve të ndryshme në institucion Rekomandohet që Institucioni duhet të trajnohet në vazhdim për metodat innovative të komunikimit.</p> <p><i>Ev. 1_36_ Faqja zyrtare e internetit.</i></p> <p><i>Ev. 1_18_ Metodat e mësimdhënies në distancë.</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Implementimi i disa metodave të teknologjisë së komunikimit, e ka lehtësuar proceset e monitorimit të aktivitetit akademik dhe administrative si dhe të raportimeve në përputhje me afatet kohore dhe specifikat. Institucioni nëpërmjet organeve dhe autoriteteve drejtuese, prodhon raporte të ndryshme në përputhje me udhëzimet MAS.</p> <p>Një nga mekanizmat me të cilat KUQ monitoron aktivitetin akademik dhe administrative është NJSBC në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore. Keto zyra funksionojnë në përputhje me statutin, rregulloren e institucionit si dhe rregullren specifike, dhe gjetjet dhe rekomandimet i tyre i finalizojnë në formën e një raporti vjetor.</p> <p><i>Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i Njsbc</i></p> <p><i>Ev. 1_5_ Rregullore e NJSBC.</i></p>




	<i>Ev. 1_13_Rregullore e ZBNJ dhe procedura.</i>			
	<i>Ev. 1_30_Shkresë përcjellëse e Raportit vjetor KUQ.</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.	Të gjitha informacionet lidhur me aktet rregullative, strukturën, programin e studimit, rregulloret specifike, aktivitetet e ndryshme janë të publikuara në faqen zyrtare të insitucionit. Njësia bazë përgjegjëse për programin nuk ka një faqe të dedikuar por është pjesë e faqes intitucionale. Gjithsesi informacioni është i aksesueshëm dhe koherente gjë që lehtëson edhe procesin e informimit të maturantëve. <i>Ev. 1_36_Faqja zyrtare e internetit.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni, disponon një sistem SMI menaxhimi me të cilin administron, menaxhon dhe ruan informacionin dhe të dhënat administrative, financiare dhe akademike. Raportohet nga evidencat dhe takimet se është në proces implementimi të sistemit të dedikuar LMS në lidhje me aksesin e dedikuar të personelit dhe studentëve. Të gjitha informacionet janë të publikuara në faqen zyrtare të insitucionit. Gjatë vizites GVJ konstatoi se regjistrat themeltarë edhe pse janë kryer procedurat e tërheqjes së tyre në përputhje me udhëzimet e MAS, ende nuk janë vënë në dispozicion nga QSHA, me të cilën ka një seri komunikime zyrtare në lidhje me çështjen. Institucioni zbaton politikat e ruajtjes së të dhënave personale, dhe ka hartuar dhe miratuar një rregullore specifike për këtë aspekt.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X.	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të	KUQ funksionon në përputhje me LAL 80/2015 dhe statutin, në lidhje me aktivitetin dhe vendimarrjen financiare. Institucioni ka Bordin administrativ si organin kolegial me të lartë dhe administratorin institucional si autoritetin më të lartë administrative. Të dy këto autoritete në bashkëpunim me Rektorin dhe Senatin, administrojnë, drejtojnë,

<p>nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>monitrojnë dhe kontrollojnë veprimtarinë financiare të institucionit. Në përputhje me statutin dhe rregulloren institucionale ata hartojnë strategji financiare zhvillimi, buxhetin afatshkurtër dhe afatmesëm si dhe raportet financiare vjetore me qëllim mbarëvajtjen e programeve të studimit.</p> <p><i>Ev. 1_1_ Statuti KUQ.</i></p> <p><i>Ev. 1_3_ Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit.</i></p> <p><i>Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NjSBC.</i></p> <p><i>Ev. 1_22_ Plani buxhetor</i></p> <p><i>Ev. 1_30_ Shkresë përcjellëse e Raportit vjetor KUQ.</i></p> <p><i>Evidencë 2_12_ Raport, plan pune dhe aktivitetet vjetore per vitin akademik 2022-2023, ZMJP&KK.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani financiar i hartuar dhe miratuar në përputhje me statutin dhe rregulloren institucionale si dhe kuadrit ligjor në fuqi përkatës të pasqyrave financiare. Plani financiar përmban elementët kryesore financiare për realizimin e programit të studimit, ku zërat kryesore të tij janë shpenzimet operative akademike dhe administrative, shpenzime për bibliotekën, detyrimet financiare, kontratat dhe shërbimet si dhe zëra të tjerë. Referuar planit financiar të deklaruar nga IAL, konstatohet që nuk ka donacione nga të tretë.</p> <p>Procedurat e hartimit të planit financiar referuar statutit inicohet nga njesitë bazë, të cilat i përcjellin bordit të administrimit propozimet për zërat e planit financiar. Evidencat e dorëzuara kanë të specifikuar këtë procedurë për veprimtarinë e kërkimit shkencor. Rekomandohet që kjo procedurë të dokumentohet edhe për zërat e tjerë të planit financiar.</p> <p><i>Ev. 1_4_2_ Rregullore e BA.</i></p> <p><i>Ev. 1_26_ Vendim i B A për pagesën e konferencave dhe bibliotekës.</i></p> <p><i>Ev. 1_27_ Miratim i fondit, për punën shkencore.</i></p> <p><i>Evidencë 2_11_ Vendimi i Senatit Akademik për ndarjen e fondit të kërkimit shkencor miratuar me vendim Bordi.</i></p> <p><i>Evidencë 2_35_ Vendim i Administratorit për mbështetjen e veprimtarive kerkimore shkencore për VA 2023-2024..pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson</p>	<p>Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, KUQ i nënshtrohet në mënyrë vullnetare auditit të brendshëm financiar. Bazuar në</p>

<p>dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>statutin e KUQ, Bordi i administrimit është garantuesi financiar i institucionit i cili miraton planin financiar afashkurtër dhe afatmesëm. Institucioni deklaron se ka kryer shlyerjen e detyrimeve ndaj autoriteteve të Tatim taksave por nuk ka evidence konkrete bashkangjitur RVB.</p> <p>Ev. _1_1_Statuti KUQ.</p> <p>Ev. _1_22_Plani buxhetor.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>KUQ ne perputhje me ligjin LAL 80/2015 harton dhe dorëzon raportin vjetor pranë MAS, pjesë e të cilit është edhe situacioni dhe ecuria financiare e tij. Ne këtë raport evidentohet realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve në përputhje me plan buxhetin.</p> <p><i>Ev. _1_30_ Shkresë përcjellëse e Raportit vjetor KUQ.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>KUQ deklaron se të ardhurat vijnë nga tarifat e studentëve. Institucioni ka një jetëgjatësi të konsiderueshme, dhe ka treguar qëndrueshmëri financiare në nivel institucional por edhe në nivel program studimi. Rekomandohet të rriten burimet e financimit.</p> <p><i>Rekomandohet që në planin strategjik afatshkurtër dhe afatmesëm të IAL-se të parashikohen burime dhe mekanizma të tjerë për burime të tjera financimi si grante, financime nga projekte kërkimore apo shërbime të ndryshme që mund të ofrojë, me qëllim stabilitetin financiar të tij.</i></p> <p><i>Ev. _1_22_Plani buxhetor.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KUQ funksionon në përputhje me LAL 80/2015 dhe statutin, në lidhje me aktivitetin dhe vendimarrjen financiare. Institucioni ka Bordin administrativ si organin kolegjal me të lartë dhe administratorin institucional si autoritetin më të lartë administrative. Plani financiar përmban elementët kryesore financiare për realizimin e programit të studimit, ku zërat kryesore të tij janë shpenzimet operative akademike dhe administrative, shpenzime për bibliotekën, detyrimet financiare, kontratat dhe shërbimet si dhe zëra të tjerë. Procedurat e hartimit të zerave të planit financiar nuk janë të dokumentuara. KUQ ne perputhje me ligjin LAL 80/2015 harton dhe dorëzon raportin vjetor pranë MAS, pjesë e të cilit është edhe situacioni dhe ecuria financiare e tij. KUQ ka si burim të ardhurave vetëm tarifat e studenteve gjë që</i></p>

	<i>paraqet risk financiar ne kuptimin afatmesem dhe afatgjate. Institucioni duhet te shtoje edhe burime te tjera financiare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni ka procedura dhe rregullore specifike për caktimin dhe miratimin e kuotave dhe kriterëve për cdo program studimi, për procedurat e informimit të maturantëve, pranimit dhe regjistrimit të studentëve, vlerësimit të tyre deri në mbylljen e plotë ciklit akademik diplomimit të tyre. Kuotat dhe Kriteret përkatëse për cdo program studimi bëhen publike në faqen zyrtare të institucioni dhe portalin U-Albania në përputhje me procedurën e pranimeve në vitin akademik dhe Udhëzimet që nxjerr MAS. <i>Ev. 1_1_ Statuti KUQ.</i> <i>Ev. 2_5_ Rregullore e FESHSS.</i> <i>Ev. 2_7_ Rregullore DESHSRS.</i> <i>Ev. 1_29_ Programi i punës për regjistrimet dhe komisionet.</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe	KUQ nëpërmjet politikave dhe procedurave që ndjek, garanton barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë studentët në hyrje dhe dalje. Institucioni ka në rregulloret e brendshme (institucionale, rregullore fakulteti, rrregullore program studimi) të specifikuar dhe miratuara procedurat në lidhje




<p>studentët e programit të studimit.</p>	<p>me pranimet dhe diplomimin e studentëve të cilat janë dhe publike në faqen zyrtare të tij. Këto procedura transparente garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatet në hyrje dhe ciklin e plotë të studimit.</p> <p><i>Ev. 2_5_ Rregullore e FESHSS.</i></p> <p><i>Ev. 2_7_ Rregullore DESHSRS.</i></p> <p><i>Ev. 1_37_ Fletëpalosje e Kolegjit.</i></p> <p><i>Ev. 1_36_ Faqja zyrtare e internetit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>KUQ është përgjegjëse për përcaktimin e kritereve përzgjedhëse në të gjitha programet e studimit që ofron dhe për këtë qëllim ka hartuar dhe zbaton një sërë aktesh rregullatorë. Pranimi i studentëve për çdo vit akademik kryhet në përputhje me kuotat dhe kriteret e propozuara dhe të miratuara për çdo program studimi, të cilat bëhen në përputhje me maturën shtetërore dhe udhëzimeve përkatëse.</p> <p><i>Ev. 1_28_ Kriteret e pranimit.</i></p> <p><i>Ev. 2_17_ Të dhëna Tabelore mbi cilësinë në hyrje të studentëve të programit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Institucioni ka zhvilluar disa mekanizma për të bërë sa më transparente dhe të kuptueshme për të gjithë të interesuarit, kriteret dhe procedurat e pranimit gjatë gjithë ciklit të studimit. Ndër më kryesoret që janë evidentuar nga KUQ janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Faqja zyrtare te KUQ; - Dita e Hapur; - Panairi Ëork and Study; - Katalogu i KUQ; - Portali i maturës shtetërore; <p><i>Ev. 2_30_ Njoftim për organizimin e ditëve të Panairit Ëork & Study.</i></p> <p><i>Ev. 2_30_ 1Raport për Ditën e Hapur; Open Day</i></p> <p><i>Ev. 1_37_ Fletëpalosje e Kolegjit.</i></p> <p><i>Ev. 1_36_ Faqja zyrtare e internetit;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të</p>	<p>Senati akademik i KUQ, çdo vit akademik në përputhje me udhëzimet e MAS parashikon në kuotat e propozuara dhe të miratuara, edhe kuota për kandidatë me aftësi të veçanta apo shtresa të marginalizuara.</p> <p><i>Ev. 1_28_ Kriteret e pranimit.</i></p>

veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	<i>Ev. 1_25_Vendimi i BA për tarifa dhe bursa.</i>			
Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>KUQ ka politika stimuluese dhe mbështetëse për disa kategori studentësh sic janë bursat e plota për maturantët me mesatë mbi 9.5 dhe bursa të pjesshme për mesatare me të ulët, me qëllim rritjen e cilësisë së studentëve dhe pranimeve në programet e studimit. Gjithashtu pervec bursave të ekselences ofrohen dhe Bursa talenti dhe Bursa sociale. Institucioni ka evidentuar vazhdimisht politika mbështetëse edhe për shtresat në nevojë apo ndihmë sociale. Bordi i administrimit shprehet me vendime specifike në lidhje me keto kuota: për ne vitin akademik 2022-2023 ka miratuar 3 kuota per keto shtresa sociale.</p> <p><i>Ev. 1_28_Kriteret e pranimit.</i></p> <p><i>Ev. 1_25_Vendimi i BA për tarifa dhe bursa.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Institucioni zbaton kuadrin ligjor ne fuqi për caktimin dhe miratimin e kuotave dhe kriterëve për cdo program studimi, si dhe për procedurat e informimit te maturantëve, pranimit dhe regjistrimit të studentëve, vlerësimit të tyre deri në mbylljen e plotë ciklit akademik diplomimit te tyre. KUQ nëpërmjet politikave dhe procedurave që ndjek, garanton barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë studentët në hyrje dhe dalje bazuar ne parimin e transparences. KUQ ka politika stimuluese dhe mbështetëse për disa kategori studentësh sic janë bursat e plota për maturantët me mesatë mbi 9.5 dhe bursa të pjesshme për mesatare me të ulët, me qëllim rritjen e cilësisë së studentëve dhe pranimeve në programet e studimit. Gjithashtu pervec bursave të ekselences ofrohen dhe Bursa talenti dhe Bursa sociale.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të	Informacioni në lidhje me kriteret e përparimit akademik të studentëve është i publikuar nëpërmjet akteve rregullative

<p>plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>institucionale, por edhe nëpërmjet publikimit të vendimeve specifike në ëeb-in e KUQ. Institucioni për programin e studimit ka një koordinatorin specifik i cili është një nga pikat referuese për informacionin e plotë dhe të hollësishëm në lidhje me procedurat e përparimit akademik të studentëve.</p> <p>Gjithashtu, organizmat e këshillave studentor dhe klubet studentore shërbejnë për informimin e studentëve apo adresimin e problematikave të tyre në organet përkatëse.</p> <p><i>Ev. 1_36_Faqja zyrtare e internetit.</i></p> <p><i>Ev. 2_15_ Vendimi për caktimin e Koordinatorit të programit të studimit.</i></p> <p><i>Ev. 2_29_ Lista e studentëve sipas grupeve.</i></p> <p><i>Ev. 1_4_3 Rregullore e Këshillit Studentor.</i></p> <p><i>Ev. 2_31_ Lista e Klubeve studentore në KUQ.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Regjistrimi i studentëve, ecuria përgjatë programit të studimit, mundësitë e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe procedura e diplomimit janë të sanksionuara në aktet rregullatorë, procedura të miratuara sic janë statute, rregullore institucionale dhe rregullorja e programit të studimit. Procesi i njohjes dhe ekuivalentimit të kualifikimeve të mëparshme realizohet nëpërmjet komisionit specifik, i cili shqyrton dokumentacionin në dosjen përkatëse që ruhet nga njësia bazë. Sekretaria mësimore gjithashtu është pjesë e procesit dhe e mbështet atë me informacionin dhe materialet përkatëse. Njoftimet mbi këtë proces, si aftet apo dokumentacionet publikohen në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale.</p> <p><i>Ev. 1_29_ Programi i punës për regjistrimet dhe komisionet.</i></p> <p><i>Ev. 3_1_ Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës, në takim me studentët dhe atë me stafin akademik konstatoi se në fillim të çdo lëndë lektori i lëndës i informon mbi syllabusin ku specifikohen kreditet, mënyrën e vlerësimit literaturë bazë dhe e këshilluar si dhe elementë të tjerë. Ky proces mbështet edhe nga koordinatori i programit të studimit si dhe drejtuesi i njësisë bazë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon</p>	<p>Programi i studimit DP “Kujdesi social dhe shëndetësor” në rregulloren e tij specifike ka të përcaktuar mënyrën e</p>

<p>studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>diplomimit dhe detyrimeve përmbyllëse. Duke qene nje program 2 vjecar profesional ai përmbyllet me provim përfundimtar. Në fillim të semestrit të dytë në vitin e dytë njësia bazë organizon dhe administron procesin e informimit mbi programin, fushat dhe lëndët që do të testohen në provimin final.</p> <p><i>Ev. 3_1_ Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional "Kujdes Social dhe Shëndetësor"</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>KUQ nëpërmjet Zyrës për marrëdhëniet me jashtë dhe këshillim për karrierë në bashkëpunim me udhëzimet e MAS orienton në mënyrë periodike informimin e studentëve të ardhshëm. Pjesëmarrja në panarin Work and Study është një mekanizëm i konsoliduar që institucioni e përdor për këtë qëllim. Gjithashtu institucioni organizon edhe ditën e hapur ku ofrohet informacion për programet e studimit dhe politikat e KUQ.</p> <p><i>Ev. 2_30_ Njoftim për organizimin e ditëve të Panairit Eork & Study.</i></p> <p><i>Ev. 2_30_ IRaport për Ditën e Hapur; Open Day.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Informacioni në lidhje me kriteret e përparimit akademik të studentëve është i publikuar nëpërmjet akteve rregullative institucionale, por edhe nëpërmjet publikimit të vendimeve specifike në web-in e KUQ por behet i ditur edhe nga koordinatori i programit te studimi. Regjistrimi i studentëve, ecuria përgjatë programit të studimit, mundësitë e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe procedura e diplomimit janë të sanksionuara në aktet rregullatorë, procedura të miratuara sic janë statute, rregullore institucionale dhe rregullorja e programit të studimit. Programi i studimit DP "Kujdesi social dhe shëndetësor" në rregulloren e tij specifike ka të përcaktuar mënyrën e diplomimit dhe detyrimeve përmbyllëse. KUQ nëpërmjet Zyrës për marrëdhëniet me jashtë dhe këshillim për karrierë në bashkëpunim me udhëzimet e MAS orienton në mënyrë periodike informimin e studentëve të ardhshëm.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Studentët informohen për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ndryshimet eventuale në programin e studimit kryesisht nëpërmjet koordinatorit të programit të studimit, sekretarisë mësimore, stafit akademik, zyrës së mardhënieve me jashtë dhe këshillimit të karrierës, fletëpalosjeve të ndryshme. Programi i studimit është program profesional dyvjeçar me 4 semestra në total ka 120 kredite.</p> <p><i>Ev. 1_12_Rregullore e sekretarisë mësimore.</i></p> <p><i>Ev. 3_6_Programet e lëndëve (syllabuset)</i></p> <p><i>Ev. 2_15_Vendimi për caktimin e Koordinatorit të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Përveç syllabuseve të lëndëve/moduleve që u vihen në dispozicion studentëve nga pedagogët përkatës, ata informohen në mënyrë të drejtpërdrejtë për literaturën dhe materiale të tjera që mund të shfrytëzohen në funksion të lëndëve. Institucioni ka një kënd të vëçantë ku publikon vazhdimisht informacion mbi planin mësimor, oraret etj.</p> <p>Rekomandohet të hartohet një katalog i programeve të studimit ku të ketë informacion mbi licensimin, akreditimin, kreditet planin mesimor dhe lëndët përkatëse.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>KUQ informon studentët për mundësitë e punësimit në menyra të ndryshme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takime me përfaqësues nga tregu i punës - Zyrës së këshillimit të karrierës - Stafit akademik gjatë praktikës profesionale - Faqes zyrtare <p>Do të ishte pozitive rritja e bashëpunimeve me kompani në tregun e punës që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e kujdesit social dhe shëndetësor si dhe ofrimi i trajnimeve specifike në këtë fushë.</p> <p>Institucioni ka realizuar një studim tregu pune mbi programin e studimit por ende është një studim që duhet</p>

	<p>përmirsuar dhe pasuruar me të dhëna reale dhe të perpunuara statistikisht nga tregu i punës.</p> <p><i>Ev. 2_13_ Studimi i Tregut "Mbi hapjen e programit të studimeve"</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Institucioni në strukturën e vet ka një sërë strukturash akademike dhe administrative të cilat, në bashkëpunim me njëra tjetrën mundësojnë përcjelljen e informacionit së përditësuar për zhvillimin e procesit mësimor dhe shërbime të tjera në funksionit të tij. Disa nga këto struktura janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra e marrëdhënieve me jashtë dhe këshillimit të karrierës; - Njësia bazë; - Koordinator i programit të studimit; - Sekretaria mësimore; - Strukturat ndihmëse; 			
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikën profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka parashikuar staf udhëheqës të dedikuar për praktikën mësimore profesionale, në bashkëpunim me aktore nga tregu i punës. Bazuar në intervistat e bëra nga GVJ gjatë vizitës, KUQ ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me një qëndër të kujdesit geriatric, por edhe shërbime të Spitalit Universitar të Traumës duke ju mundësuar studentëve kryerjen e praktikës profesionale aty.</p> <p>GVJ rekomandon që të rritet numëri i bashkëpunimeve me forma të ndryshme në tregun e punës, të mundësohet akses i studentëve te këto struktura si dhe të rriten ditët informative në lidhje me fushat e punësimit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Studentet informohen kryesisht nëpërmjet koordinators të programit të studimit, sekretarisë mësimore, stafit akademik, zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe këshillimit të karrierës, fletëpalosjeve të ndryshme. Do ishte i dobishëm të hartohet një katalog i programeve të studimit ku të ketë informacion mbi licensimin, akreditimin, kreditet planin mesimore dhe lëndët përkatëse. Institucioni ka realizuar një studim tregu pune mbi programin e studimit por ende është një studim që duhet përmirsuar dhe pasuruar me të dhëna reale dhe të perpunuara statistikisht nga tregu i punës. KUQ informon studentët për mundësitë e punësimit në menyra të ndryshme por duhet te rritet mundësia per aksesin e studenteve per praktika ne tregun e punes.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

			X	
--	--	--	---	--

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Referuar rregulloreve të institucionit, sekretaria mësimore është struktura përgjegjëse për ruajtjen e statistikave vjetore të studentëve të regjistruar, të diplomuar si dhe të transferuar apo ata që vazhdojnë program të dytë studimi. GVJ gjatë vizitës në sekretari, konstatoi se sekretaria i mbantë të dhënat në formë elektronike dhe hard copy. Konkretisht ky program studimi ka 21 sudente ne total ku 8 ne vitin e pare dhe 21 ne vitin e dyte te studimeve. IAL referuar komunikimit zyrtar ka zbatuar procedurat për kërkesën dhe tërheqjen e regjistrave themeltarë të programit të studimit nga QSHA, por ende nuk është finalizuar procesi. Ky process duhet të përfundojë para diplomimit pasi të dhenat e diplomimit duhe të reflektohen e regjistrat e diplomimit.</p> <p><i>Ev. 1_12_Rregullore e sekretarisë mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studenteve, menaxhohen nga sekretaria mësimore në bashkëpunim me stafin akademik, dhe aksesohen nga persona të autorizuar.</p> <p>Të dhënat ruhen në përputhje me rregulloren specifike për ruajtjen e të dhënave personale. Stafi akademik mban regjistrat personale, ku evidenton zhvillimin e procesit mësimor dhe në bashkëpunim me sekretarinë mësimore verifikojnë ecurinë akademike të studentëve.</p> <p>Rekomandohet të investohet në një platformë elektronike të dedikuar për menazhimin e të dhënave të studentëve si dhe ofrimin online të shërbimeve si vërtetim notash, vërtetim ecurie etj.</p> <p><i>Ev. 1_12_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e</p>	<p>Sekretaria mësimore bazuar në statut, informon dhe raporton organet dhe autoritet drejtuese me informacionin e saktë në lidhje me numërin e studentëve dhe veprimtaritë e tyre.</p> <p>Struktura që monitoron edhe vlerëson procesin e ruajtjes dhe menaxhimit të të dhënave nga IAL dhe vecanërisht sekretaria</p>

<p>menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>mësimore është NJSBC. Kjo zyrë kryen vlerësime periodike të cilat janë pjesë e raportit vjetor.</p> <p><i>Ev. 1_30_ Shkresë përcjellëse e Raportit vjetor KUQ.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit “Kujdes social dhe shëndetësor” është Departamenti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Rekreacionit Sportiv. Kjo njësi kryen analiza vjetore të cilat i paraqet në formën raportit vjetor, ku trajtohet ndër të tjera edhe cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje si dhe plan masat përkatëse për të përmirësuar proceset akademike.</p> <p>Rekomandohet institucioni të monitorojë zbatimin e plan masave në kuadër të raporteve dhe analizave vjetore.</p> <p><i>Ev. 2_9_ Analiza vjetore e ESHSRS.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Referuar rregulloreve të institucionit, sekretaria mësimore është struktura përgjegjëse për ruajtjen e statistikave vjetore të studentëve të regjistruar, të diplomuar si dhe të transferuar apo ata që vazhdojnë program të dytë studimi. Të dhënat ruhen në përputhje me rregulloren specifike për ruajtjen e të dhënave personale. Staf i akademik mban regjistrat personale, ku evidenton zhvillimin e procesit mësimor dhe në bashkëpunim me sekretarinë mësimore verifikojnë ecurinë akademike të studentëve. Do të ishte pozitive krijimi i një platforme të dedikuar për këto qëllime dhe përmirësuar proceset akademike</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.




Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Në përputhje me Statutin e KUQ, studentët janë të përfaqësuar në disa organe kolegjiale dhe komisione specifike sic janë: Senati Akademik, NJSBC, Këshilli i Etikës, Grupet e vlerësimit të brendshëm etj. Bazuar në Evidencat e RVB, studentët marrin pjesë edhe në mbledhjet e njësisë bazë, mekanizem i duhur për të dëgjuar zërin e tyre në procese të ndryshme. Ata mund të shprehin mendimet dhe argumentet e tyre në lidhje me proceset akademike dhe administrative të institucionit duke cuar në një model drejtimi bashkëpunues dhe efikas të IAI-së.</p> <p><i>Ev. 1_1_ Statuti KUQ.</i></p> <p><i>Ev. 1_4_3 Rregullore e Këshillit Studentor.</i></p> <p><i>Ev. 1_5_ Rregullore e NJSBC</i></p> <p><i>Ev. 2_32_ Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njësisë.</i></p> <p><i>Ev. 2_3_ Vendim Dekani, "Për miratimin e Grupit të Vetvlërsimit të Brendshëm, GVB" si dhe Vendim "Për propozimin e GVB Nr. 160 dt.22.11.2023"</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Institucioni e rregullon procesin e garantimit të përfshirjes së studentëve në vendimmarrje, këshillim apo propozime nëpërmjet Statutit dhe rregulloreve që rrjedhin prej tij. Studentët duke u përfaqësuar si anëtarë në disa organe kolegjiale apo grupe pune jo vetëm që mund të japin mendimin e tyre por dhe ndikojnë e direkt në vendimmarrje pasi kanë të drejtë vote në to. Bashkëpunimi me Këshillin studentor dhe senatorët në funksion të roleve përfaqësuese të studentëve në jetën institucionale e bën lehtësisht të verifikueshme dhe të matshme efikasitetin e kësaj strategjie dhe mekanizmi.</p> <p><i>Ev. 2_32_ Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njësisë.</i></p> <p><i>Ev. 1_4_3 Rregullore e Këshillit Studentor.</i></p> <p><i>Ev. 2_29_ Lista e studentëve enator sipas grupeve..</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e</p>	<p>Njësia bazë siguron përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit me disa mekanizma si përfshirja në mbledhjet e njësisë, takimet e drejtpërdrejta apo plotësimi i pyetësorëve në grup fokuse të ndryshme të cilat reflektojnë në mënyre direkt mendimet dhe sygjërimet e studentëve.</p>

<p>tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>GVJ rekomandon qe keto pyetesore te perpunohen ne menyre elektronike, dhe bazuar ne to te propozohen masa te implementeshme.</p> <p><i>Ev. 2_32 Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njësisë;</i></p> <p><i>Ev. 2_26_1 Model template, Pyetësi i studentit;</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>KUQ ka të përcaktuar qartë në Statut, rregulloren e kolegjit, rregulloren e njësisë kryesore si dhe atë të programit të studimit të drejtën e studentit për ankimin gjatë procesit të vlerësimit të dijeve dhe njohurive si dhe të drejtën e rishikimit të vlerësimit. Konkretisht studenti njihet me rezultatet e vlerësimit të njohurive brenda 5 diteve nga zhvillimi i procesit të vlerësimit të dijeve. Studenti ka të drejtën e apelimit dhe rishikimit në një afat kohor 48 orë. GVJ gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik nuk konstatoi ndonjë rast problematike ndoshta edhe për shkak të numërit të vogël të studentëve dhe kohës së vogël të aktivizimit të programit të studimit “Kujdes social dhe shëndetësor”.</p> <p><i>Ev. 1_1 Statuti KUQ.</i></p> <p><i>Ev. 1_4 Rregullore e Kolegjit.</i></p> <p><i>Ev. 3_1 Rregullore e programit të studimit me Karakter Profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në përputhje me Statutin e KUQ, studentët janë të përfaqësuar në disa organe kolegjiale dhe komisione specifike sic janë: Senati Akademik, NJSBC, Këshilli i Etikës, Grupet e vlerësimit të brendshëm. Bashkëpunimi me Këshillin studentor dhe senatorët në funksion të roleve përfaqësuese të studentëve në jetën institucionale e bën lehtësisht të verifikueshme dhe të matshme procesin. Studentet japin mendimin e tyre nepermjet mekanizmit te pyetesoreve ne grup fokuse te ndryshme te cilat duhet te perpunohen elektronikisht nga IAL. KUQ ka të përcaktuar qartë në Statut, rregulloren e kolegjit, rregulloren e njësisë kryesore si dhe atë të programit të studimit të drejtën e studentit për ankimin gjatë procesit të vlerësimit të dijeve dhe njohurive si dhe të drejtën e rishikimit të vlerësimit</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	KUQ ka struktura specifike në shërbim të informimit të studentëve Zyrën e mardhënive me jashtë dhe këshillimit të karrierës e cila në bashkëpunim me sekretarinë mësimore dhe njësië bazë koordinon të gjithë procesin e informimit. Kjo zyrë e mbështet veprimtarinë e vet në Statut, dhe rregulloren specifike te saj duke perdorur një sërë mjetesh si faqen zyrtare të Ial-së, fletëpalosje, ditët e hapura, apo edhe rrjetet sociale. <i>Ev. _1_14_Rregullore e ZMJP&KK.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni ka një sërë mekanizmash për informimin, këshillimin dhe monitorimin e përparimit të studentëve si dhe mbështetjet në proceset akademike. Ndër to permendim ZMJP&KK, këshillin studentor, sekretaria mësimore dhe kooridinatori i programit të studimit por ende nuk ka krijuar një sistem të mirëfilltë elektronik që të lehtësojë komunikimin midis tyre dhe të rrisë eficensën e procedurave që ato mbulojnë. GVJ, rekomandon që KUQ të përfshijë në strategjitë e saj zhvillimin e një platforme elektronike e cila do të lehtësonte komunikimin midis studentëve, administratës dhe stafit akademik.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione	Zyra për mardhëniet me jashtë dhe këshillim karriere e ka në objektivat e saj informimin e studentëve për orientimin e studentëve në lidhje me kryerjen e praktikës profesioanle dhe tregut të punës. Në funksion të ketij objektivi kjo zyrë në kuadër të marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve që ka me të tretët propozon dhe nxit politika stimuluese për ti përfshirë studentët në tregun e punës. <i>Ev. _1_14_Rregullore e ZMJP&KK.</i> <i>Ev. _1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit.</i>

të tjera dhe orientimin në tregun e punës.									
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Zyra për marrëdhëniet me jashtë dhe këshillim karriere bazuar në rregulloren e saj, është përgjegjëse për krijimin dhe ruajtjen e databasës dhe të dhënave për punësimin e alumini si dhe gjurmimin e tyre. IA1 nuk ka paraqitur evidencë konkrete për sistemin dhe menyrën e funksionimit të gjurmimit të alumini në përgjithësi sepse për programin “Kujdes social dhe shëndetësor “ sepse ende nuk është diplomuar gjenerata e parë dhe ky process do të vijojë në një kohë me të vonshme. GVJ rekomandon të hartohet një udhëzues specifik për gjurmimin e alumini gjë do ta lehtësonte procesin dhe krijonte një database efikas.								
Konkluzione	<i>KUQ ka struktura specifike në shërbim të informimit të studentëve Zyrën e marrëdhënieve me jashtë dhe këshillimit të karrierës e cila në bashkëpunim me sekretarinë mësimore dhe njësi bazë koordinon të gjithë procesin e informimit. Institucioni ka një sërë mekanizmash për informimin, këshillimin dhe monitorimin e përparimit të studentëve si dhe mbështetjet në proceset akademike por duhet te krijoje mundesi per komunikim sa me efikas mes tyre perms teknologjive informatike dhe dixhitale. Zyra për marrëdhëniet me jashtë dhe këshillim karriere kren gjurmimin e alumni por ende nuk ka nje udhezues specifik per menyren e funksionimit te ketij procesi.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional ne “Kujdes Social dhe Shëndetësor” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar Qirjazi”

Pikat e forta dhe afirmime

1. KUQ ka hartuar dhe implementon dokumentin mbi “Politikat e Vlerësimit të Brendshëm”;
2. Vlerësimi rregullisht i stafit akademik nga studentët dhe eprori;
3. Studentët e pranuar kishin mesatare të lart në hyrje;
4. Program unik në Shqipëri i cili përgatit student si në fushën e kujdesit social ashtu dhe shëndetësor.
5. KUQ ka infrastrukturë të përshtashme për të zhvilluar programin e studimit
6. Institucioni ka mekanizat rregullative dhe adminsitrativ per vlerësimin, përfshirjen e studentëve ne jeten institucionale

Pika të dobta

1. Marrëveshjet për këtë program studimi deri në këtë moment janë të pakta dhe kjo është një pikë e dobët që Institucioni duhet të punoj më shumë; (Standardi I 2 kriteri 2)
2. Mungesa e stafit ndihmës akademik me karakter mësimor; (Standardi I 3 kriteri 2)
3. Institucioni nuk ka hartur ndonjë udhëzues specifik për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies; (Standardi II 4 kriteri 2)
4. GVJ vëren se stafi akademik dhe studentët nuk kanë zhvilluar mobilitete jashtë Shqipërisë; (Standardi III 1 kriteri 3)
5. Mungesa e sistemeve elektronike të kontrollit dhe vlerësimit e testimit dhe ruajtjes së të dhënave (Standardi V 6 kriteri 2)

Rekomandime

1. GVJ sugjeron që Institucioni të rrisi numërin e marrëveshjeve me institucione brenda dhe jashtë vendit për realizimin e praktikave profesionale;
2. GVJ konsideron se prezenca e ekspertëve të jashtëm do të ishte një vlerë e shtuar dhe për këtë arsye sugjeron se rregullisht të përfshihen të tillë;
3. Hartimin e një udhëzuesi specifik për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies;
4. Misioni dhe objektivat specifike të programit të studimit duhet të përfshihen në Rregulloren e programit të studimeve;
5. GVJ konsideron si të rëndësishme që KUQ të ketë në përbërje edhe staf ndihmës akademik me karakter mësimor;
6. Përmirësimi i kurrikulës duke përfshirë disa element që mungojnë (ose prezantohen bashkë) si dhe duke ofruar lëndët bazë në semestrin e parë të studimeve;
7. Rritja e orëve të praktikës profesionale të studentëve;
8. Rritje e numërit të mobiliteteve të stafit akademik dhe studentëve;



9. Zhvillimin e disa platformave elektronike per drejtimin dhe administrimin e procesve akademike.

Evaluation's conclusions for the professional study program "Social and Health Care" provided by the Higher Education Institution " Kolegji Universitar Qirjazi "

Strengths and affirmations

1. KUQ has drafted and is implementing the document entitled "Policies for Internal Assessment;
2. Regular assessment of the academic staff by the students and the supervisor;
3. Average grade of the students at admission eas high;
4. Unique program in Albania ehich prepares students both in the field of social and health care.
5. Lack of electronic systems of control and assessment of testing and data storage

Weaknesses

1. Agreements for this study program up to this moment are feë and this is a ëeak point that the Institution should ëork on more;
2. Lack of academic support staff that focuses on the educational process;
3. Absence of any specific guidelines/documents for the use of innovative teaching methods;
4. External evaluation committee (EEC) notes that academic staff and students have not conducted any mobility abroad;
5. Lack of any electronic evaluation/control systems.

Recommendation

1. EEC suggests that the Institution increase the number of agreements ëith institutions inside and outside the country for the realization of professional practice;
2. EEC considers that the presence/inclusion of external experts ëould be an added value and therefore suggests that they be regularly included;
3. Drafting a specific guidelines/documents for the use of innovative teaching methods;
4. The mission and specific objectives of the study program should be included in the Regulation of the study program;



5. EEC considers it important that KUQ also includes academic support staff that focuses on the educational process;
6. Improving the curriculum by including some elements that are missing (or presented mixed) as well as by offering the basic subjects in the first semester of studies;
7. Increasing the hours/credits of professional practice of the students;
8. Increasing the number of mobility for both academic staff and students;
9. The development of several electronic platforms for the management and administration of academic processes.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

